



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave “Filozofi sociale”

ofruar nga

Universiteti i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Genti Kruja

PhD. Jordan Jorgji

Maj/2025


TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Master i Shkencave i Nivelit të Dytë në “Filozofi Sociale”

1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Filozofisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Filozofi Sociale”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 1272, datë 17.09.2008
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 208, datë 19.06.2023
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	V.a 2022-2023: 10 PAE/ 7 PAK V.a. 2023-2024: 10 PAE/ 5 PAK
18	Numri i studentëve:	V.a 2022-2023: 13 studentë V.a 2023-2024: 10 studentë
19	Komente / të tjera:	-

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjimn. «Q. Stafan», Tiranë
Tel: 363 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al





PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave në Filozofi Sociale" është miratuar me Urdhrin nr. 540, datë 09.11.2012 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe Vendimin Nr. 379, datë 26.10.2012 të Këshillit të Akreditimit pranë MASI-I. Ky program fokusohet në ndërthurjen e filozofisë me aspektet sociale të jetës, duke analizuar ndikimin e ideve filozofike në shoqëri dhe rolin e tyre në zhvillimin dhe transformimin e strukturave sociale, politike dhe kulturore.

Masteri është i dizajnuar për studentët që dëshirojnë të thellohen në analizën filozofike të çështjeve sociale, të zhvillojnë aftësi kritike dhe analitike, si dhe të kuptojnë dhe interpretojnë sfidat shoqërore. Programi është i hapur jo vetëm për studentët me diplomë Bachelor në Filozofi, por edhe për ata që kërkojnë të përfitojnë njohuri të avancuara mbi rëndësinë e filozofisë në shoqërinë shqiptare.

Ky program dallon për qasjen ndërdisiplinore dhe përqendrimin në zhvillimin e aftësive që ndihmojnë në identifikimin dhe zgjidhjen e problematikave sociale sipas sektorëve specifikë. Misioni i tij është të ofrojë një trajnim të thelluar në filozofinë sociale dhe të forcojë kapacitetet analitike për të kuptuar dhe adresuar ndryshimet shoqërore dhe ndikimet e ideve filozofike në to. Programi synon të formojë profesionistë të aftë për të kontribuar në zhvillimin e politikave, kulturës dhe shoqërisë në përgjithësi.

Pas përfundimit të studimeve, studentët mund të ndjekin karriera në akademi, kërkim shkencor, organizata joqeveritare që merren me çështje sociale, politika publike dhe media. Ata përgatiten për të qenë liderë të mendimit dhe kontribues në zhvillimin e një shoqërie më të drejtë dhe të barabartë, duke bashkuar teorinë me praktikën në kontekste të ndryshme shoqërore.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Filozofi Sociale”, të ofruar nga Departamenti i Filozofisë në Universitetin e Tiranës, filloi me prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të vlerësimit të brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

ASCAL bazuar në *“Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”*, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UT, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. Asoc. Genti Kruja dhe Dr. Jordan Jorgji.

Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinator Teknik të ASCAL-it, Znj. Rajna Lila.

Vizita 2 ditore në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale u realizua gjatë datave 3-4 shkurt 2025, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas axhendës së vizitës në IAL. Gjatë vizitës u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të Fakultetit të Shkencave Sociale, Departamenti i Filozofisë. Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL, si dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL.

Në fund të raportit, ekspertët kanë hartuar disa rekomandime me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Filozofi Sociale”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti i Tiranës (UT) është Institucion publik i Arsimit të Lartë i cili rregullon veprimtarinë e tij në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë. Programet e studimit që ofron UT i përmbahen Ligjit 80/2015 të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, përfshirë edhe normat juridike-administrative të këtij universiteti, si Statuti, Rregullorja dhe dokumentet e njësive më të decentralizuara (rregullorja e njësisë kryesore dhe asaj bazë). Si i tillë, UT ofron programe studime që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Gjithashtu, falë përvojës së gjatë në mësimdhënie dhe në kërkim shkencor të UT, synohet ruajtja dhe konsolidimi i vlerave kombëtare dhe atyre akademike. UT dhe njësitë akademike përbërëse të tij ofrojnë programe studimi sipas niveleve 6-8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, sipas ligjit nr.10 247, dt. 4.3.2010. Evidenca: 1.2. Statuti i UT <https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2019/08/Statuti_2018.pdf> 1.3. Rregullore e UT <https://unitir.edu.al/rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022/> 1.4. Strategjia e UT <https://unitir.edu.al/strategjia-e-zhvillimit-te-universitetit-te-tiranes-per-periudhen-2023-2028/> -- Korniza Shqiptare të Kualifikimeve, sipas ligjit nr.10 247, dt. 04/03/2010, <https://qsha.gov.al/wp-content/uploads/2023/08/ligj_10247-2010_04032010.pdf> (nuk citohet në dokumentacion).
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si	Programi i studimit Master Shkencor në Filozofi Sociale është hartuar në përputhje me qëllimet, misionin dhe vizionin e UT, i cili është zhvillimi i shoqërisë përmes edukimit, kërkimit shkencor dhe shërbimit ndaj publikut. Paralelisht, hartimi i programit të

dhe fushën e veprimtarisë.	studimit në nivelin e 7-të të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve është në përputhje me kuadrin ligjor për arsimin e lartë për sa i përket fushës së veprimtarisë së shkencave sociale, dhe më konkretisht ofrimit dhe administrimit të shërbimeve sociale. Evidenca: 1. dhe 11. Kuadri konceptual i programit të studimit (dok.shtesë). 2. Strategjia e programit të studimit (dok.shtesë). 2.6. Struktura e programeve të studimit të FSHS për të tre ciklet e studimit. -- Misioni dhe vizioni i UT <https://unitir.edu.al/vizioni-dhe-misioni/> (nuk citohet në dokumentacion).
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimeve akademike të Institucionit.	Programi i studimit funksionon në përputhje me strategjinë institucionale për mësimdhënien (objektivat 1 deri 7), me Statutin dhe me rregulloren e UT si dhe me objektivat e Strategjisë së Zhvillimit të fakultetit ku ky program studimi bën pjesë. Filozofia sociale është një nga fushat akademike që mbulon Departamenti i Filozofisë (DF) dhe Fakulteti i Shkencave Sociale (FSHS). Kjo përputhshmëri me drejtimet akademike të njësive në fjalë, pjesë e UT, plotësohet nga harmonia e programit të studimit me qëllimet dhe objektivat e Strategjisë për zhvillimin e departamentit dhe me drejtimet strategjike të Strategjisë për zhvillimin e programit të studimit. Evidenca: 1.2. Statuti i UT <https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2019/08/Statuti_2018.pdf> 1.24. Strategjia institucionale për mesimdhënien 2022-2027 1.3. Rregullore e UT https://unitir.edu.al/rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022/ 2. Strategjia e programit të studimit (dok.shtesë). 2.3. Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Sociale 99. Rregullore e Programit të studimit Master i shkencave në Filozofi Sociale. 101. Strategjia e zhvillimit të Departamentit të Filozofisë.
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit	Falë cilësisë dhe integritetit të stafit akademik të angazhuar në programin e studimit, transparencës dhe përditësimit të kurrikulës, si dhe bashkëpunimit me universitete prestigjioze në vendet e Bashkimit Evropian, programi i studimit është në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026 për sa i përket shërbimit të interesit kombëtar dhe ndërkombëtarizimit. Programi

mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.

i studimit përcjell misionin e UT për kultivimin e dijes dhe të cilësive morale-shoqërore, për përgatitjen e profesionistëve që administrojnë shërbimet sociale, të motivuar për të punuar në rajone të ndryshme të Shqipërisë në përputhje me kërkesat e tregut të punës, si dhe për kultivimin e mendimit kritik dhe produktiv. Hartimi dhe përditësimi i programit është gjithashtu në kohezion me Strategjinë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017-2022, me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, Strategjinë Kombëtare e Punësimit dhe e Aftësive, si dhe me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030.

Departamenti organizon konferenca periodike shkencore në fushën e filozofisë, ku rrahen problematikat kryesore në nivel kombëtar dhe më gjerë. Në përmirësimin e kurrikulës së programit të studimit me trendet globale të dimensionit social të filozofisë, departamenti shrytëzon bashkëpunimet që ka me partnerë socialë, si brenda ashtu dhe jashtë Shqipërisë, por edhe përvojën e stafit akademik në mobilitete dhe projekte ndërkombëtare. Një lëndë e tillë që pasqyron prirjet aktuale ndërkombëtare në përditësimet kurrikulare, sipas takimit që realizuam me stafin akademik, është *Lëvizjet sociale të shekullit XX*.

Rekomandohet që departamenti mund të shtojë në të ardhmen lëndë që pasyrojnë prirjet kryesore në hapësirat ndërkombëtare dhe transnacionale të cilat karakterizojnë shoqëritë e Globalizmit. Mgjith ky nuk përbën konstatim që ndikon në programin e studimit.

Evidenca:

91 dhe 12 (dok.shitesë). Plan Mesimor

105. Të dhëna për aktivitet e kerkimit shkencor te realizuara.

--Strategjia kombëtare për arsimin 2021-2026,

<<https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2021/05/Draft-Strategjia-per-Arsimin-2021-2026.pdf>>

--Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017-2022, <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2019/07/Vendim-i-KM_710_01.12.2017_Strategjia-e-Kerkimit-Shkencor.pdf>

--Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, <<https://www.kryeministria.al/strategjia-kombetare-per-zhvillim-dhe-integrim-2015-2020/>>

--Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe e Aftësive.

	https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/561 --Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/WEB_Strategjia-Kombetare-AL.pdf			
Konkluzione	Pjesë e UT, programi i studimit Master shkencor në Filozofi Sociale është hartuar dhe funksionon në përputhje me misionin dhe qëllimin e UT për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, dhe në një kontekst më të gjerë ai ruan dhe përcjell interesat dhe vlerat e përgjithshme sipas strategjive kombëtare, përfshirë edhe prirjet e aktorëve prestigjiozë ndërkombëtarë. Programi funksionon në përputhje me statutin dhe rregulloren e UT, si dhe dokumentacionin përkatës të njësisë kryesore dhe asaj bazë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	UT dhe FSHS kanë në organikën e vet një staf të kualifikuar akademik, që ndërthur njohuritë akademike me ekspertizën e pasur në fushat specifike. Një pjesë e rëndësishme e stafit të programit të studimit është e kategorisë Profesor (1 prof.dr. dhe 4 prof.as.dr.) ndërsa Personeli Akademik me Kontratë (PAK) ka përvojë bashkëpunimi me aktorë të rëndësishëm të shoqërisë, si Instituti i Sociologjisë, Banka e Shqipërisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Turizmit, Instituti për integrimin e ish të përndjekurve politikë, etj. Gjithashtu, departamenti siguron bashkëpunim me institucione të rëndësishme shoqërore dhe sociale falë marrëveshjeve për realizimin e praktikave profesionale të studentëve, por edhe marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka firmosur njësia kryesore dhe UT si IAL. Evidenca: 2.20. Politika e FSHS për zhvillimin profesional të personelit akademik 2020 19. Veprimtaria kerkimore nivel departamenti (dok.shtesë) 20. Pjesëmarrje e stafit ne projekte (dok.shtesë) 24. Aktivitete dhe kualifikimi shkencor i stafit 5 vitet e fundit

	(dok.shitesë) 73. CV e Pedagogeve te Jashtem. 82. Lista e Marreveshjes per praktiken mesimore profesionale. 83. Lista e Pedagogeve te Jashtem 2023-2024. 95. Raport Vjetor departamenti i filozofise viti akademik 2023-2024.
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit Master shkencor në Filozofi Sociale realizohet për një periudhë 2-vjeçare, me kohë të plotë dhe me 120 kredite ECTS. Ai ofron studime të thelluara në fushën e filozofisë sociale. Fusha e përgjithshme e programit të studimit (filozofi) i përket humaniteteve (filofi, etikë, religjion) ndërsa ajo specifike (filozofi sociale) është në përputhje me shkencat sociale të Fakultetin e Shkencave Sociale (FSHS) brenda së cilës operon ky program studimi. Kjo i referohet Udhëzimit Nr. 31 dt. 15/11/2022 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për kodifikimin e programeve të studimit, të cilat citojnë Standardin Ndërkombëtar të Klasifikimit në Edukim (ISCED 2011), ku programi në fjalë është brenda kategorisë 3 të Shkencave Sociale, biznesit dhe ligjit, dhe nënkategorisë 3.1. Shkencat sociale dhe ato të sjelljes. <u>Programi Master i shkencave, jo më pak se 120 ECTS (72MS) në Shkencat humane (përveç gjuhëve) [022] i korrespondon kodit 0223 të fushës "Filozofi dhe etikë".</u> Evidenca: 2.3. Strategjia e Zhvillimit e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023-2028 101. Strategjia e zhvillimit te Departamentit te Filozofise. --Udhëzim nr 31 dt. 15/11/2022, <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2022/11/Udhezim-Nr.31-date-15.11.2022-Kodifikimi-i-programeve-te-studimit-IAL-pdf.pdf> --Vendim nr. 310 dt. 11/05/2022 për Specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit, <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2023/12/vendim-310-date-11.05.2022.pdf> --International Standard Classification of Education ISCED 2011, <https://uis.unesco.org/sites/default/files/documents/international-standard-classification-of-education-isced-2011-en.pdf>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e	Në ngjashmëri me kriterin e mësipërm (kriterin 2), programi i studimit Master shkencor në Filozofi sociale si humanitet është në përputhje me fushën akademike e kërkimore-shkencore të Departamentit të Filozofisë (DF), dhe në një fare mënyre edhe me fushën e shkencave sociale të Fakultetit të Shkencave Sociale

kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	(FSHS) për arsien e dimensionit social të filozofisë (Filozofi sociale) që karakterizon programin e studimit. Për sa i përket drejtimin të programit të studimit, ky i fundit mbulohet nga departamenti në fjalë dhe nuk ka karakter ndër-departamentar. Evidencat: 2. <i>Strategjia e programit të studimit (dok.shtesë).</i> 99. <i>Rregullore e Programit të studimit Master i shkencave në Filozofi Sociale.</i> 101. <i>Strategjia e zhvillimit të Departamentit të Filozofisë.</i>
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	N/A
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	UT ofron mundësi për trajnimin profesional të mëtijshëm për studentët e diplomuar (alumni), siç duket në tabelën përmbledhëse me trajnime. Në FSHS funksionon shërbimi i karrierës i cili ofron shërbime informimi, këshillimi dhe trajnimi për studentët dhe ata të diplomuar. Mbajtja e kontakteve me këta të fundit realizohet në mënyrë elektronike përmes një linku të veçantë. Nga gjurmimi i fundit në nivel fakulteti rezulton se ka një shkallë të lartë punësimi të studentëve të diplomuar. Gjithashtu, studentët marrin pjesë në panairët e punës ndërkohë që nëse ata kanë kërkesa mund të ndihmohen për t’u trajnuar nga një pjesë e pedagogëve të jashtëm (PAK) që vijnë nga institucionet me të cilat bashkëpunon departamenti. Departamenti mban kontakte të rregullta me studentët e diplomuar, të cilët ftohen në veprimtari relevante që organizon departamenti, siç janë konferencat periodike ku diskutohen problematikat aktuale në fushën e filozofisë dhe të filozofisë sociale. <i>Megjithatë, produkti i kontakteve me studentët alumni mund të operacionalizohet më mirë me anën e tryezave të rrumbullakëta ku të diskutohen problematikat e ndryshme në lidhje me eficiencën e kurrikulës së programit dhe sfidave të studentëve kur këta të fundit dalin në tregun e punës. Duke qenë se FSHS disponon një staf të kualifikuar akademik dhe thith profesionistë nga institucionet</i>

	partnere, fakulteti ka mundësi që të organizojë në të ardhmen panairë pune posaçërisht në fushën e shkencave sociale. Evidenca: 1.20. Vendim SA për ngritjen e qendrës virtuale të trajnimit dhe zhvillimit profesional. 1.26. Studimi-i-tregut-te-punes_UT 2022. 2.22. Rregullore e Zyrës së Këshillimit për Karrierë 2021. 102. Studim Tregu Viti akademik 2023-2024 --Linku i përdorur për mbledhjen e të dhënave <https://forms.office.com/r/P4uvëBvEqg> --Shëbimi i karrierës në FSHS <https://fshs-ut.edu.al/rreth-fakultetit/sherbimi-i-karrieres> -- Zyra e karrierës në UT <https://unitir.edu.al/marredheniet-me-studentet-dhe-karriera/>			
Konkluzione	Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion dhe po ashtu në harmoni me fushën e gjerë të njësisë kryesore. Staf i angazhuar ka përvojë të konsiderueshme në njohurit akademike dhe në ekspertizën profesionale. Rekomandohet organizimi i tryezave të rrumbullakëta me studentët dhe studentët e diplomuar (alumni) me qëllim përmirësimet kurrikulare në raport me shoqërinë bashkëkohore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e	DF e realizon mbarëvajtjen e programit të studimit në respekt të rregulloreve të departamentit, të fakultetit (FSHS) dhe të universitetit (UT) përfshirë edhe Statutin e UT. Nëpërmjet këtyre normave dhe në bazë të Ligjit Nr. 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, të cilin e reflektojnë normat e përmendura (statutin dhe rregulloret), veprimi shtrihet tek stafi akademik i angazhuar në programin e studimit si dhe në hallkat e tjera ndihmuese, si personeli administrativ dhe studentët. Në këtë

personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	mënyrë DF ndan detyrat për funksionimin e programit të studimit dhe përmbushjen e nevojave të ndryshme relevante. Mbarëvajtja realizohet përmes një ndarje vertikale të strukturuar mes njësive kryesore dhe njësive bazë, ku përfshihet edhe caktimi i një koordinatorit përgjegjës për programin e studimit. Me propozim të DF, FSHS ka caktuar një koordinator për programin e studimit, i cili mbikqyr funksionimin e programit të studimit dhe së bashku me përgjegjësin e njësive bazë siguron mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe të nevojave relevante. Evidencat: 1.2. Statuti i UT <https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2019/08/Statuti_2018.pdf> 1.3. Rregullore e UT <https://unitir.edu.al/rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022/> 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023. 74. Emrat e Koordinatorëve Departamenti i Filozofisë 99. Rregullore e Programit të studimit Master I shkencave në Filozofi Sociale
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Për realizimin e objektivave të programit të studimit, DF shfrytëzon marrëdhëniet e bashkëpunimit që ai si departament por edhe FSHS së bashku me UT kanë vendosur me institucione partnere dhe me aktorë të shoqërisë të biznesit. Gjithashtu, DF ka një sfond të pasur bashkëpunimi me universitete prestigjioze evropiane, nga të cilat edhe është diplomuar një pjesë e stafit akademik. Kjo vërehet tek pjesa e partneriteteve dhe e ndërkombëtarizimit të Strategjisë së Zhvillimit të DF, dhe gjithashtu na u vu në dukje në takimin që patëm me personelin PAE dhe PAK. Evidenca: 5. Raport mbi përfitimin nga marrëveshjet (dok.shitesë) 82. Lista e Marrëveshjeve për praktiken mësimore profesionale 94, 95, 96. Raporte Vjetore Viti akademik 2022 101. Strategjia e zhvillimit të Departamentit të Filozofisë 20-2024.
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të	Marrëveshjet ndahen kryesisht në praktikën profesionale që studentët kryejnë pranë institucioneve partnere. Departamenti dhe fakulteti ruajnë një gamë të gjerë bashkëpunimi me institucione lokale që lidhen me sektorin e politikave publike (Bashkia e Tiranës) dhe më konkretisht me institucionet të cilat lidhen me sektorin e shërbimeve sociale.

fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Gjatë kryerjes së praktikës profesionale zbatohet manuali i praktikës, plotësohet ditari i praktikës dhe hartohet një ese e veçantë, të cilat shërbejnë për vlerësimin e studentit. Nga takimi me studentët rezultoi një përvojë pozitive në lidhje me realizimin e praktikës profesionale. Evidenca: 5. Raport mbi përfitimin nga marrveshjet (dok.shtesë) 75. Format Ditari Praktike Profesionale Departamenti Filozofiese 82. Lista e Marrveshjeve per praktiken mesimore profesionale
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	DF mbikqyr eficiencën e praktikës profesionale dhe raporton në mënyrë periodike përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit. Problemet që dalin diskutohen në analizat periodike të departamentit dhe në raportet e NJSBC-së. Nga takimi me studentët dhe sektorin e karrierës dhe alumnit nuk rezultuan probleme të veçanta në lidhje me realizimin e praktikës profesionale. Në takimin me stafin akademik na u tha se studentët punësohen kryesisht në fushën e gazetarisë, si këshillues karriere apo edhe në zyrat e burimeve njerëzore. Është pikërisht gama e gjerë e grup-lëndëve ajo që mundëson edhe gamën e gjerë në punësimin e studentëve të diplomuar. Në kontekstin aplikativ rekomandohen kontakte të rregullta me institucionet e praktikës profesionale në formën e tryezave të rrumbullakëta, me qëllim operacionalizimin sa më eficient të mundësive që ofron praktika për thellimin e njohurive dhe punësimin e studentëve. Evidenca: 2.16. Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale 2021-2022, 2022-2023. 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024. 5. Raport mbi përfitimin nga marrveshjet 94, 95, 96. Raporte Vjetore Viti akademik 2022
Konkluzione	Në funksion të përmbushjes së programit të studimit, DF ka vendosur një gamë të gjerë bashkëpunimi me institucione partnere, përfshirë edhe universitete prestigjioze evropiane. Një pjesë e marrëveshjeve të bashkëpunimit konkretizohen tek praktikat profesionale të studentëve. Rekomandohen diskutime periodike me institucionet partnere për evidentimin e problematikave dhe përmirësimet e mundshme, kurrikulare.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit është i organizuar dhe i strukturuar në kredite, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe në harmoni me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve. Plani mësimor aktual i programit të studimit është i përbërë nga : 1. A: Lëndët bazë (8 ECTS - 7%), 2. B: Lëndët Karakterizuese (64 ECTS - 53%), 3. C: Lëndët Ndërdisciplinore/Integruese (24 ECTS – 20%), 4. D: Lëndët plotësuese (12 ECTS - 10%) 5. E: Detyrimet përmblëse (12 ECTS - 10%). Siç vihet re, fokusi kryesor përqendrohet tek lëndët karakterizuese (B) të cilat përbëjnë gjysmën e ngarkesës së planit mësimor për të gjithë programin e studimit. Në përfundim të programit studenti grumbullon një total prej 120 kredite ECTS. Organizimi i planit mësimor është në harmoni me VKM nr. 41 dt. 24/01/2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë. <i>Ky program studimi është në përputhje me ligjin, ku 70% e lëndëve mbulohen nga pedagogët e brendshëm, ndërsa disa lëndë me karakter ndërdisciplinor (juridik-politik) nga pedagogë të jashtëm.</i>

	Evidenca: 91 dhe 12 (dok.shitesë). Plan Mesimor 99. Rregullore e Programit te studimit Master I shkencave ne Filozofi Sociale -- VKM nr. 41 dt. 24/01/2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë.
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i studimit ka si mision kultivimin e aftësive dhe të prirjeve të studentëve si qytetarë të përgjegjshëm, me qëllim që ata të angazhohen në mënyrë profesionale dhe të bazuar mbi norma etike, për të konceptuar, drejtuar dhe trajtuar problematikat sociale që karakterizojnë shoqëritë. Këto aftësi kultivohen falë studimit të thelluar të dimensionit social të shoqërisë, me fokus kryesor përgjegjësinë etike dhe përgatitjen e drejtimit (udhëheqësisë). Programi është i hartuar i tillë dhe funksionon në mënyrë që të ndërthurë përvetësimin e njohurive të thelluara teorike me aplikimin e tyre në terren (konkretisht në praktikën institucionale), duke kultivuar paralelisht mendimin kritik në konceptimin dhe trajtimin e çështjeve me karakter social. Kjo ndërthurje synon të përgatisë sa më mirë student për kërkesat e tregut të punës. Karakteri ndërdisiplinor i programit të studimit e bën të nevojshëm koordinimin sistematik jo vetëm me palët e angazhuara në mësimdhënie dhe në praktikën profesionale, por akoma më tej me ekspertët që përfaqësojnë institucione relevante me programin e studimit dhe si të tillë janë të përditësuar me problematikat e përditshme të shërbimeve sociale. Vlerësoret se DF është i hapur në afrimin e tyre si PAK. <i>Rekomandohet një bashkëpunim më i thelluar me këtë kategori ekspertësh në formën e takimeve të institucionalizuara. Këta mund të ndihmojnë në përditësimin e kurrikulës, në shkathtësimin e studentëve me tematikat sociale si një fushë studimi me karakter aplikativ, si dhe në orientimin e studentëve të diplomuar në sektorin relevant të punësimit.</i> Evidenca: 1 dhe 11 (dok.shitesë). Kuadri konceptual i programit te studimit 1.25. Plani strategjik i UT per zhvillimin e personelit akademik 2023-2028 VS-6-date-30.01.2023 2. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit (dok.shitesë) 101. Strategjia e zhvillimit te Departamentit te Filozofise 20-2024

Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Transmetimi i njohurive të thelluara ndërthurret me karakterin aplikativ të praktikës profesionale, të cilën programi i studimit e ka organizuar në një semester me një total prej 12 kreditesh ETCS, si dhe me hulumtimin e temës së diplomës në lëndët e detyrimeve përmbyllëse, me gjithashtu 12 kredite ETCS. Të dyja këto i korrespondojnë 20% të ngarkesës së programit të studimit (12% praktika profesionale dhe 12% mikroteza). Evidenca: 1.9. Rregullore-për-diplomimin UT 2.11. Rregullore e Diplomimit FSHS 91 dhe 12 (dok.shitesë). Plan Mesimor
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit.	N/A
Kriteri 5. Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	N/A
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe	<i>Programi i studimit Master Shkencor në Filozofi sociale nuk bën pjesë në programet e studimeve me status të veçantë.</i>




financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet	Nga takimi me stafin akademik dhe përgjegjësin e departamentit nga u konfirmua se në Shqipëri nuk ka program studimi të ciklit të dytë Master shkencor që ofrohet në të njëjtën fushë studimi dhe me të njëjtën emërtesë.
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimit respekton procesin e kodifikimit sipas dokumenteve të cituara në evidencat e këtij kriteri. Evidenca: -- Udhëzimi i MAS nr. 31 dt. 15/11/2022 për procedurat e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga IAL në Republikën e Shqipërisë, <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2022/11/Udhezim-Nr.31-date-15.11.2022-Kodifikimi-i-programeve-te-studimit-IAL-pdf.pdf>. -- Vendim nr. 310 dt. 11/05/2022 për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga IAL në Republikën e Shqipërisë, <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2023/12/vendim-310-date-11.05.2022.pdf>.
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky kriter nuk i përket programit të studimit Master shkencor në Filozofi Sociale, pasi ky program studimi nuk ka programe të përbashkëta me institucione të tjera të arsimit të lartë.
Konkluzione	Programi i studimit ndërthur njohuritë teorike me aspektin aplikativ. Ai i kushton një vëmendje të veçantë praktikës profesionale dhe detyrime përmbyllëse, të cilat i korrespondojnë 20% të ngarkesës mësimore. Rekomandohet diskutimi periodik i institucionalizuar i efikasitetit të kurrikulës në lidhje me tregun e punës.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																								
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	FSHS dhe DF organizojnë punën e tyre sipas normave në fuqi të UT dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar. Struktura akademike miratohet çdo vit nga Senati Akademik, në koordinim me njësitë kryesore dhe ato bazë, të cilat janë përgjegjëse për organizimin e veprimtarisë së tyre dhe stafit përkatës akademik. Vlerësimi dhe menaxhimi i cilësisë kryhet çdo vit nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në nivel FSHS. NJSBC bashkëpunon me DF për përmbushjen e veprimtarisë vlerësuese të programit të studimit. Ajo kryhen pyetësorë periodikë me studentë, ku pas përpunimit të të dhënave përfundimet i bëhen të ditura dekanit ose zv/dekanit si dhe përgjegjësve të departamenteve, me qëllim që këta të fundit t'i bëjnë objekt të analizave të tyre brenda departamentit dhe në nivel program studimi. NJSBC bashkëpunon me njësinë homologe në nivel rektorati si dhe me përfaqësuesit e ASCAL. Për sa i përket procesit të akreditimit të programeve të studimit, Departamenti cakton një grup pune (GVB) i cili harton Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dhe organizon evidencat përkatëse në bashkëpunim me departamentin dhe me strukturat e tjera të UT. <i>Të dhëna për Departamentin e Filozofisë:</i> <table><tr><th rowspan="2">Tituj/ grada</th><th colspan="2">2022 – 2023</th><th colspan="2">2023 – 2024</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr.</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>2</td><td>-</td><td>2</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr./PhD.</td><td>6</td><td>4</td><td>5</td><td>4</td></tr></table>	Tituj/ grada	2022 – 2023		2023 – 2024		PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	1	-	1	-	Prof. Asoc.	2	-	2	-	Dr./PhD.	6	4	5	4
Tituj/ grada	2022 – 2023		2023 – 2024																						
	PAE	PAK	PAE	PAK																					
Prof.Dr.	1	-	1	-																					
Prof. Asoc.	2	-	2	-																					
Dr./PhD.	6	4	5	4																					

	Msc.	2	1	2	1
	Totali	11	5	10	5
Evidenca: 1.2.Statuti i UT <https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2019/08/Statuti_2018.pdf> 1.6. Rregullore per sigurimin e cilesise ne UT. 1.6.1. Rregullore për-organizmin-dhe-funksionimin-e-njesive-te-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise 2022. 2.12. Vendim i FSHS-së për ngritjen e Njesisë së Sigurimit të Cilësisë. 2.15. Të dhena per NJSC (tabela 24) dhe GVB. 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024.					
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	DF në koordinim me FSHS angazhon personelin akademik efektiv (PAE) dhe personelin administrativ për realizimin e praktikës profesionale të studentëve të programit të studimit, e cila organizohet në një semester (semestri i II i vitit të II). Organizimi i praktikës profesionale dhe ai i programit të studimit në përgjithësi, realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me aktet normative të UT. Në realizimin e praktikës profesionale DF ndihmohet nga personeli administrativ, 1 (një) sekretare e procesit mësimor dhe zyra e IT-së. <i>Numri i krediteve të praktikës profesionale në planin mësimor 2023-2024 (12 kredite ETCS) nuk korrespondon me programin lëndor të praktikës (silabusin) e vitit 2022-2023 dhe 2023-2024, ku lënda paraqitet me 6 kredite ETCS.</i> Evidenca: 1.7. Rregullore per vleresimin e performances ne pune personel ndihmes akademik dhe administrativ. 2.5. Struktura organizative e FSHS 2024. 91 dhe 12 (dok.shtesë). Plan Mesimor 75. Format Ditari Praktike Profesionale Departamenti Filozofise 108-109 dhe 113-114. PROGRAME 2022-2024				
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në	Siç sqarohet më sipër, në standardin I.3 kriteri 1, FSHS, me propozim të DF, ka caktuar 1 (një) koordinator të programit të studimit. i cili mbikqyr funksionimin e programit të studimit dhe së bashku me përgjegjësin e njësisë bazë siguron mbarëvajtjen e				

rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	procesit mësimor, të praktikave profesionale dhe të nevojave relevante. Evidencat: 74. Emrat e Koordinatorëve Departamenti i Filozofise 99. Rregullore e Programit të studimit Master I shkencave në Filozofi Sociale			
Konkluzione	DF, në koordinim me FSHS, përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacion, në lidhje me organizimin dhe strukturën akademike, vlerësimin dhe akreditimin. Ato angazhojnë personel akademik dhe administrativ për realizimin e praktikave profesionale, si dhe caktohet një koordinator përgjegjës për mbikqyrjen e punës në programin e studimit. Rekomandohet hartimi i manualit të praktikës profesionale dhe përshtatja e programit lëndor me planin mësimor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3 Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	DF ka hartuar dhe zbaton programin e studimit në bazë të informacionit sipas legjislacionit në fuqi. Kështu, është organizuar struktura e programit të studimit me lëndët e formimit të përgjithshëm, të përgatitjes disiplinore, të formimit ndërdisiplinor dhe atyre që përcjellin njohuri plotësuese, së bashku me detyrimet përmbyllëse. Informacioni i nevojshëm pasqyrohet në dokumentacionin bazë të këtij programi studimi, siç janë plani mësimor, programet lëndore dhe rregullorja e programit. Informacioni në planin mësimor dhe në programet lëndore është shprehur në elementë cilësorë (tematikat, lëndët) dhe sasiorë (orët mësimore dhe jashtë auditorit, ngarkesa mësimore, kreditet ETCS, etj). Evidenca: 1 dhe 11 (dok.shitesë). Kuadri konceptual i programit të studimit 91 dhe 12 (dok.shitesë). Plan Mësimor 99. Rregullore e Programit të studimit Master I shkencave në

	<i>Filozofi Sociale</i> 108-109 dhe 113-114. <i>PROGRAME 2022-2024</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi mësimor përmban planin mësimor, i organizuar në 15 lëndë të tipologjisë A deri në F, të cilat i përkasin gjithësej 120 kredite ETCS dhe të shtrira në një hapësirë kohore prej dy vitesh. Më konkretisht, plani mësimor përmban: A: Lëndë të formimit të përgjithshëm e metodologjik (8 kredite) - 1 lëndë ose 7% e planit mësimor; B: Lëndë për përgatitjen e disiplinës shkencore (64 kredite) - 9 lëndë ose 53% e planit mësimor; C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese (24 kredite) - 5 lëndë ose 20% e planit mësimor; D: Praktika profesionale (12 kredite) - 1 lëndë ose 10% e planit; E: Lëndë përmbyllëse – mikroteza – (30 kredite) – 1 lëndë ose 10% e planit mësimor. Gjithsej 120 kredite ETCS – 100% e planit mësimor (19 lëndë). Evidenca: 91 dhe 12 (dok.shitesë). <i>Plan Mësimor</i> 99. <i>Rregullore e Programit të studimit Master I shkencave në Filozofi Sociale</i> 108-109 dhe 113-114. <i>PROGRAME 2022-2024</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme që lidhen me kriteret e pranimit, si dhe me transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve. Ndiqen kriteret e përgjithshme pranimi, të përcaktuara nga kuadri ligjor në fuqi, si dhe kriteret specifike të propozuara nga DF dhe FSHS çdo vit. --Kriteret e përgjithshme janë: a) Mbarimi i shkollës së mesme; b) Plotësimi i kriterit të notës mesatare; c) Respektimi i kuotave të propozuara nga DPPS dhe të miratuara nga Senati Akademik i UT; --Kriteret specifike janë: A) Gjuha e huaj e certifikuar. B) Kanë përparësi studentët e FSHS dhe të UT. DF mundëson transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve në bazë të Statutit dhe të Rregullores së UT, si dhe të dokumentacionit rregullator të fakultetit dhe të departamentit. Evidenca:

	1.2. Statuti i UT <https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2019/08/Statuti_2018.pdf> 1.22. Kriteret e pranimi 2024-2025. 1.3. Rregullore e UT <https://unitir.edu.al/rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022/> 2.31. Ngritja e grupeve të punës për pranimet e reja në ciklin e pare dhe të dytë të studimeve në Fakultetin e Shkencave Sociale, për vitin akademik 2024-2025. 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023. 80. Komisioni i shqyrtimit 2022-2023 99. Rregullore e Programit të studimit Master I shkencave në Filozofi Sociale
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit përmban programet lëndore (silabuset) e detajuara sipas formatit të miratuar nga Senati Akademik i UT. Silabuset detajohen në përputhje me kërkesat ligjore, duke ofruar informacionet e mëposhtme: organizimin tematik, objektivat e lëndës, metodat e mësimdhënies dhe të vlerësimit, përkatësinë me kredite dhe me orë studimi brenda dhe jashtë auditorit, format e frekuentimit dhe pjesëmarrjes, si dhe literaturën e detyruar dhe të rekomanduar. Silabusi miratohet çdo vit nga përgjegjësi i departamentit dhe nga dekani. Nga takimi me studentët na u pohua që pedagogët janë transparentë me informimin e studentëve për të gjitha elementët përbërës të lëndës sipas silabusit përkatës. <i>Gvj konstatoi se numri i krediteve të disa lëndëve në planin mësimor 2023-2024 nuk korrespondon me programet lëndore (silabuset) e vitit 2023-2024. Shembuj të tillë janë lëndët: Etika sociale me 8 kredite në plan dhe 5 kredite në silabus, Probleme të moralit me 8 kredite në plan dhe 5 kredite në silabus dhe Praktikë me 12 kredite në plan dhe 6 kredite në silabus.</i> Evidenca: 91 dhe 12 (dok.shitesë). Plan Mesimor 108-109 dhe 113-114. PROGRAME 2022-2024
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe	Në fillim të vitit akademik ndërmerren përmirësime të programit të studimit dhe të programeve lëndore, në respekt të lirisë akademike dhe të gjyqimit të departamentit sipas vlerësimeve të marra nga studentët. Ndryshimet kurrikulare deri në 20% miratohen nga Senati Akademik. Megjithatë, do të ishte pozitive të na vihej në dispozicion një praktikë e ndryshimeve kurrikulare të programit mësimor.

arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	<i>Rekomandohet organizimi i tryezave të rrumbullakëta me përfaqësues të institucioneve partnere, të biznesit, me studentët e diplomuar (alumni) dhe me studentët, ku të shprehen vlerësime konkrete për efikasitetin e programit kurrikular me kërkesat e tregut të punës. Kjo do të ndihmonte në përmirësimet e studiuara kurrikulare dhe që i rezistojnë kohës.</i> Evidenca: 2. Strategjia e programit të studimit (dok.shtesë) 2.14. Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave. 91 dhe 12 (dok.shtesë). Plan Mesimor 92. Plani i Punes.			
Konkluzione	<i>Programi i studimit është i detajuar, informues dhe i strukturuar në përputhje me strategjinë dhe me objektivat formuese. Përmirësimet kurrikulare kryhen në përputhje të legjislacionit në fuqi, të lirisë akademike dhe të nevojës për rritjen e efikasitetit të programit të studimit. Rekomandohen më tepër takime me palët partnere për dëgjimin e propozimeve të tyre në lidhje me përmirësimin e programit të studimit për sa i përket kërkesave të tregut të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Organizimi i planit mësimor dhe i programeve lëndore të programit të studimit kryhen në përputhje me kornizën konceptuale të programit dhe kanë qëllim ndërthurjen e njohurive të thelluara me përgatitjen e ekspertëve në fushën e administrimit të shërbimeve sociale. Kjo realizohet nëpërmjet kombinimit të leksioneve dhe seminareve me orët e kushtuara në praktikën profesionale. Thellimi i njohurive siguron aftësi të konsoliduara për studime të mëtejshme në ciklin e tretë të studimeve.

	Evidenca: 1 dhe 11 (dok.shitesë). Kuadri konceptual i programit të studimit 75. Format Ditari Praktike Profesionale Departamenti Filozofise 91 dhe 12 (dok.shitesë). Plan Mesimor 92. Plani i Punes. 108-109 dhe 113-114. PROGRAME 2022-2024
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Shpërndarja e ngarkesës është e balancuar në vite dhe semestra, me qëllim arritjen e objektivave formuese të programit të studimit. Fillohet me lëndët bazë të detyrueshme, të cilat ofrojnë përgatitje teorike dhe metodologjike, pra kulturë të përgjithshme, dhe vazhdohet më pas me lëndët karakterizuese që ofrojnë aftësi profesionale për fushën e studimit. Në lëndë të caktuara aplikohen detyra kursi, me anë të së cilave synohet prezantimi i rezultateve të punimeve të studentëve. Evidenca: 91 dhe 12 (dok.shitesë). Plan Mesimor 92. Plani i Punes. 108-109 dhe 113-114. PROGRAME 2022-2024
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Struktura e programit të studimit është në përputhje me profilin e programit të studimit, në respekt të legjislacionit shqiptar, por edhe në harmoni me parimet e Kartës së Bolonjës dhe Sistemit Evropian të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve (ETCS). Departamenti vuri në dukje se në hartimin e programit të studimit u morën parasysh modelet e universiteve prestigjioze evropiane, kryesisht atyre italiane ku një pjesë e stafit ka kryer studimet universitare dhe postuniversitare. <i>Rekomandohen studime periodike të kurrikulës së universiteve prestigjioze evropiane për të parë se cilat janë prirjet kryesore që shoqërojnë përmirësimet kurrikulare. Këto studime dhe përshtatje të kurrikulës së programit të studimit duhen evidentuar me dokumentacion.</i> Evidenca: 91 dhe 12 (dok.shitesë). Plan Mesimor 92. Plani i Punes.
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e	Kurrikula e programit të studimit siguron pajisjen e studentëve me njohuritë e nevojshme teorike dhe mundëson arritjen e objektivave formuese nëpërmjet formimit praktik. Programi është më shumë i orientuar në formimin teorik dhe konceptual të studentëve, pasi formimi i thelluar teorik i ndihmon studentët në vazhdimësinë e

objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	studimeve në ciklin e tretë. Praktika profesionale realizohet në semestrin e dytë të vitit të dytë, është element i rëndësishëm që aftëson studentin në tregun e punës, duke njohur më mirë kërkesat e kësaj të fundit. <i>Duke u nisur nga orientimi teorik i programit të studimit, rekomandohet që në të ardhmen të rritet dimensionin e aplikuar i tij.</i> Evidenca: 91 dhe 12 (dok.shitesë). Plan Mesimor 92. Plani i Punës. 99. Rregullore e Programit të studimit Master I shkencave në Filozofi Sociale 108-109 dhe 113-114. PROGRAME 2022-2024
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Programet lëndore (silabuset) përmirësohen çdo vit nga pedagogu titullar në respekt të lirisë akademike, dhe më pas miratohen nga përgjegjësi i departamentit dhe nga dekan. Kujdes i veçantë i kushtohet përditësimit të tematikave me aktualitetin e dijes si dhe përditësimit të literaturës më të fundit, kryesisht e 5 (pesë) viteve të fundit. Kjo mund të jetë literaturë e detyrueshme ose e rekomanduar, në bashkëpunim edhe me sektorin e bibliotekës, me qëllim lehtësimin e studentit në aksesimin e burimeve. Në takimin me stafin, na u vu në dukje si arritje pozitive përditësimi i literaturës në programet lëndore – përtej vështirësive që ekzistojnë në fushën e filozofisë – dhe kryesisht në blerjen e literaturës së përzgjedhur, e cila është e disponueshme në fondin e bibliotekës së FSHS. Evidenca: 2.25. Të dhëna për bibliotekën. 2.25.1. Të dhëna të plota për platformat on-line tabela 17. 2.27. Dokument mbi librat e fundit për bibliotekën. 99. Rregullore e Programit të studimit Master I shkencave në Filozofi Sociale 108-109 dhe 113-114. PROGRAME 2022-2024
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programit dhe kurrikula e saj garanton përfitimin e njohurive të thelluara teorike dhe të aftësive praktike për të dalë si profesionist në tregun e punës. Përmirësimet e silabusave dhe ato kurrikulare kanë si qëllim aktualizimin e programit të studimit me problematikat bashkëkohore konceptuale – përtej atyre klasike – dhe me nevojat aktuale të tregut të punës. Pozitive është ndërmarrja e studimit të tregut të punës nga UT dhe

	kryesisht nga DF, i cili përbën një vlerësim të statutit të punësimit tek studentët e Departamentit të Filozofisë për vitin 2023-2024. <i>Rekomandohet një bashkëpunim më i institucionalizuar dhe formalizuar me institucionet partnere dhe biznesin (psh në formën e tryezave të rrumbullakëta dhe diskutimeve sistematike) me qëllim që programi i studimit të jetë sa më i prekshëm për nevojat aktuale të shoqërisë shqiptare.</i> Evidenca: 1.26. Studimi-i-tregut-te-punes_UT 2022 102. Studim Tregu Viti akademik 2023-2024. 2.14. Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave. 91 dhe 12 (dok.shitesë). Plan Mesimor 92. Plani i Punes. 108-109 dhe 113-114. PROGRAME 2022-2024
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimitin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi i studimit në përmbajtjen e tij përcjell njohuri të thelluara teorike dhe raste studimi, me qëllim që studenti të aftësohet për vazhdimin e ciklit të tretë të studimeve. Paralelisht, praktika institucionale dhe njohja me tiparet e shërbimeve publike e sociale të shoqërisë shqiptare e përgatit studentin për t'u përballur me kërkesat e tregut të punës. <i>Rekomandohet pasurimi i kurrikulës me lëndë që i referohen vendeve të BE-së ose/dhe OECD-së, apo edhe e vendeve të tjera, me qëllim që studenti të aftësohet edhe në hapësira të tjera më të gjera.</i> Evidenca: 91 dhe 12 (dok.shitesë). Plan Mesimor 92. Plani i Punes. 102. Studim Tregu Viti akademik 2023-2024.
Konkluzione	<i>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Programi i studimit i aftëson studentët me njohuri të thelluara për vazhdimin e studimeve në ciklin e tretë. Gjithashtu, struktura e programit siguron aftësi kompetencash praktike, me qëllim përballjen e suksesshme me tregun e punës. Rekomandohet përditësim i kurrikulës me prirjet e vendeve të BE/OECD, duke i</i>

	<i>shërbyer ndërkombëtarizimit të tregut të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecures së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Në përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit merren parasysh kërkesat e tregut të punës, të cilat UT dhe DF i kanë matur në studime të veçanta. Vlen të theksohet <i>Vlerësimi i statutit të punësimit tek studentët e Departamentit të Filozofisë për vitin 2023-2024</i>, studim të cilin departamenti e realizoi në periudhën e cituar në titull. Gjithashtu, në takim me studentët dhe me stafin akademik u theksua nga të dyja palët se DF është i hapur për të pritur dhe analizuar sugjerimet që vijnë nga studentët. <i>Mund të rekomandohet krijimi i një web-i të veçantë që to të shërbente si hapësirë për qarkullimin e mendimit konstruktiv dhe për bashkëpunimet e mundshme.</i> Evidenca: 1.26. <i>Studimi-i-tregut-te-punes_UT 2022.</i> 82. <i>Lista e Marreveshjes per praktiken mesimore profesionale.</i> 102. <i>Studim Tregu Viti akademik 2023-2024.</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Komunikimi me studentët realizohet përmes kontakteve që Shërbimi i Karrierrës, si pjesë përbërëse e FSHS, vendos me ta, kryesisht përmes pyetësorëve dhe krijimit të të dhënave pas diplomimit, kryesisht në lidhje me punësimin e tyre. Gjithashtu, studentët pyeten periodikisht nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe në raportet e saj reflektohen rregullisht mendimet e studentëve. Studentët kanë organet e tyre përfaqësuese dhe si rregull ata kanalizojnë nëpërmjet tyre kërkesat ndaj institucionit. DF dhe FSHS ka qenë gjithmonë mikëpritës ndaj kërkesave të studentëve dhe kjo na u vu në dukje edhe gjatë takimit që zhvilluam me këta të fundit. Në RVB thuhet se koordinatori organizon diskutime me studentët

	në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. Kjo është një ndërmarrje pozitive, megjithatë, rekomandohen forma të institucionalizuara dhe të dokumentuara të ndërveprimit me studentët për sa i përket marrjes së mendimit të tyre në lidhje me studimet e kryera dhe sfidat me të cilat ata ndeshen në tregun e punës. Kështu, përtej pyetësorit të shërbimit të karrierës, DF mund të organizojë tryeza vjetore të rrumbullakëta me studentët efektivë dhe ata të dipomuar, ku të diskutohen përditësimet e mundshme të programit të studimit me qëllim që ai të jetë sa më eficient. Evidenca: 1.20. Vendim SA per ngritjen e qendrës virtuale te trajnimit dhe zhvillimit profesional. 1.23. Rregullore për zgjedhjet e këshillave të studentëve në Universitetin e Tiranës. 2.14. Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave.pdf 2.22. Rregullore e Zyrës së Këshillimit për Karrierë 2021. 2.23. Politika për mbështetjen për studentët dhe strukturat e tyre organizative.
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	DF ka ndërmarrë një studim të profilizuar tregu për profesionet që lidhen me programet e studimit të ofruara nga ky departament. Kjo është një ndërmarrje për t'u përshëndetur, e cila konkretizon studimin e përgjithshëm të tregut në nivel IAL (UT) me të dhëna që i afrohen njësisë bazë. Pozitive janë gjithashtu ndërmarrjet për organizimin e konferencave vjetore, për të cilat rekomandohet ilustrimi i tyre me praktika konkrete (thirrje, agjenda). <i>Rekomandohen forma të institucionalizuara dhe të dokumentuara të ndërveprimit me institucione partnere dhe aktorë të rëndësishëm socialë për sa i përket marrjes së mendimit të tyre në lidhje me eficiencën e programit të studimit në nevojat që dikton tregu i punës. Kështu, DF mund të organizojë tryeza vjetore të rrumbullakëta ku të diskutohen përditësimet e mundshme kurrikulare, qoftë në lëndë të caktuara, por edhe për sa i përket raportit të orëve teorike me ato praktike.</i> Evidenca: 6 dhe 14. Praktike e përmirësimit të kurrikulës (dok.shtesë) 82. Lista e Marreveshjes për praktiken mesimore profesionale. 91 dhe 12 (dok.shtesë). Plan Mesimor

	92. Plani i Punes.			
Konkluzione	<i>DF nxit përfshirjen e studentëve dhe të institucioneve partnere në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Megjithatë, rekomandohen forma të institucionalizuara dhe periodike me ta, me qëllim vjeljen e feedback-ut të tyre për sa i përket efikasitetit të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e vendosura.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit është në përputhje me objektivat madhorë të UT si IAL, dhe konkretisht me mësimdhënien cilësore, kërkimin shkencor dhe përgatitjen profesionale. Drejtimet prioritare akademike përcaktohen nga Statuti dhe Rregullorja e UT, së bashku me strategjinë institucionale. Përmirësimi i mësimdhënies ndërmerret nëpërmjet matjeve periodike dhe raporteve përkatëse. Performanca e kërkimit shkencor sigurohet si rezultat i punës së stafit të angazhuar por edhe e konferencave vjetore që DF organizon në fushën e filozofisë. Përveç diskutimeve teorike dhe shkëmbimit të përvojave në këto konferenca, këto të fundit shërbejnë për rrjetëzimin dhe bashkëpunimin e pjesëmarrësve. Evidenca: 1.2. Statuti i UT <https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2019/08/Statuti_2018.pdf> 1.24. Strategjia institucionale për mesimdhënien 2022-2027 vendim-nr.24. 1.25. Plani strategjik i UT për zhvillimin e personelit akademik 2023-2028 VS-6-date-30.01.2023. 1.3. Rregullore e UT <https://unitir.edu.al/rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022/> 1.4. Strategjia e UT <https://unitir.edu.al/strategjia-e-zhvillimit-te-universitetit-te-tiranes-per-periudhen-2023-2028/> 1 dhe 11 (dok.shitesë). Kuadri konceptual i programit të studimit 2.10.Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxënësve dhe provimet.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	20. Pjesëmarrje e stafit në projekte (dok.shitesë) 24. Aktivitete dhe kualifikimi shkencor i stafit 5 vitet e fundit (dok.shitesë) 78. Kerkimi Shkencor mbi mesimdhënien. 94. Raport mbi veprimtarine kerkimore shkencore per vitin 2021-2022, 2022-2023, 2023-2024.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mesimdhënies, veprimtaritë kerkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	DF nxit përmirësimin e veprimtarisë së mesimdhënies në realizimin e procesit mësimor me atë të kërimit shkencor, duke respektuar lirinë akademike të pedagogut. Paralelisht me raportet periodike të NJSBC-së dhe vlerësimin e performancës në nivel vertikal nga përgjegjësi i departamentit, pedagogu mat performancën e vet në përfundim të një moduli, me qëllim përmirësimin e mundshëm të mesimdhënies. Kjo na u konfirmua nga takimi me stafin akademik dhe me studentët. Stafi ka një përvojë të konsoliduar jo vetëm në mesimdhënie, por edhe në veprimtarinë shkencore. Ai është i angazhuar në pjesëmarrjen në konferenca të ndryshme shkencore si dhe në shkrimin e punimeve shkencore relevante me fushën e studimit. Në kontekstin e ndërthurjes së cilësisë së mesimdhënies dhe përvojës institucionale – shkencore, DF organizon leksione dhe orë të hapura me personalitete të rëndësishme të fushës së studimit. Evidenca: 4. Praktike e oreve të hapura (dok.shitesë) 94. Raport mbi veprimtarine kerkimore shkencore per vitin 2021-2022, 2022-2023, 2023-2024. 105. Te dhena per aktivitetet e kerkimit shkencor te realizuara.
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kerkimore.	DF nxit studentët të angazhohen në studime, aktivitete shkencore dhe projekte kerkimore. Kjo na u konfirmua në takimet me stafin akademik dhe me studentët, ku u theksua se janë shfrytëzuar mundësitë për pjesëmarrjen e studentëve në projektet kerkimore-shkencore, në prezantimin e punimeve në konferenca shkencore në bashkautorësi me pedagogë të programit të studimit si dhe në projektet kerkimore-shkencore. Në takimin me stafin akademik, u përmend organizimi i konferencës për Kosovën, por edhe konferencat për çështjen e fesë dhe të etikës, ku pjesëmarrja e studentëve ishte e kënaqshme. DF angazhon studentët në hartimin e detyrave të kursit ku studentët aftësohen në hulumtimin e burimeve shkencore dhe përgatiten kështu gradualisht për punimin e tyre të diplomës.

	Studentët mund të shfrytëzojnë informacionit që disponon biblioteka e FSHS. Studentët e programit të studimit marrin pjesë në konferencën shkencore vjetore që organizohet në nivel UT, por edhe në konferencën vjetore që DF organizon me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Filozofisë. <i>Rekomandohet të vihet në dispozicion programi ose praktika e konferencës.</i> Studentët kanë gjithashtu mundësi të marrin pjesë në programet e mobilitetit me institucionet partnere të UT, diçka që nuk është shfrytëzuar maksimalisht nga studentët e këtij programi studimi. <i>Rekomandohet që studentëve t'u vihet në dispozicion një informacion i detajuar në lidhje me mundësitë që ofrohen, dhe më pas të procedohet në raporte se sa shfrytëzohen këto mundësi.</i> Evidenca: 3. <i>Praktike pjesëmarrje në mobilitete studente (dok.shitesë)</i> 94. <i>Raport mbi veprimtarinë kërkimore shkencore për vitin 2021-2022, 2022-2023, 2023-2024.</i> 105. <i>Te dhena për aktivitetet e kërkimit shkencor të realizuara.</i>
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Për realizimin e veprimtarisë studimore dhe kërkimore-shkencore, UT mbështet njësinë bazë me një fond të dedikuar në formë Grandi, në varësi të kërkesave të dokumentuara me shpenzime. Gjithashtu, UT dhe FSHS ndihmon departamentin në aplikimin e projekteve kërkimore-shkencore dhe ato infrastrukturore në nivel BE (fondet Erasmus+). Nga takimi me sektorin e projekteve na u konfirmua një angazhim modest i stafit në projektet me BE-në, ku janë përfshirë edhe studentët. Këto cilësohen si hapa të rëndësishme në ndërkombëtarizimin e programit të studimit, edhe pse mbetet akoma shumë për tu bërë. <i>Rekomandohet ndërgjegjësimi i stafit akademik për t'u përfshirë më shumë në përdorimin e Grandit dhe të thirrjeve të tjera të cilat financojnë kërkimit shkencor.</i> Evidenca: 1.18. <i>Vendim BA Për miratimin e programit të Grantit për konferenca ndërkombëtare.pdf</i>
Konkluzione	<i>Programi i studimit garanton orientimin në fushën e studimeve dhe të kërkimit shkencor, qoftë nëpërmjet ndërthurjes në kërkimit shkencor me veprimtarinë kërkimore-shkencore, por edhe në përfshirjen e studentëve në veprimtarinë kërkimore-shkencore.</i>

	Rekomandohet një informacion i organizuar dhe i detajuar në lidhje me përfshirjen e studentëve dhe shfrytëzimin e mundësive të ekzistojnë, duke u paraprirë nga informimi dhe ndërgjegjësimi i studentëve. Mbeten hapa për t'u ndërmarrë në programet e mobilitetit dhe të kërkimit shkencor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	DF siguron realizimin e grupeve lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore nga ana e stafit akademik në bashkëpunim me studentët. Me qëllim pasurimin e përvojës së studentëve me profesionin e drejtimit dhe të lehtësuesit të shërbimeve sociale, departamenti organizon leksione të hapura me ekspertë të fushës. Gjithashtu, për të forcuar lidhjet me tregun e punës janë afruar si pedagogë të jashtëm (PAK) përfaqësuesë të institucioneve me të cilat departamenti apo njësitë më sipër tij kanë marrëveshje bashkëpunimi. Evidenca: 94. Raport mbi veprimtarinë kërkimore shkencore për vitin 2021-2022, 2022-2023, 2023-2024. 95. Raport Vjetor departamenti i filozofisë viti akademik 2023-2024. 96. Raport Vjetor Viti akademik 2022. 105. Te dhëna për aktivitetet e kërkimit shkencor të realizuara.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	DF angazhon personelin akademik PAE dhe PAK për ndërmarrjen e studimeve të ndryshme në bashkëpunim me studentët. Në RVB theksohet orientimi i studentëve në hulumtimin dhe punimin e temës së diplomës. Interesi i lartë i departamentit në ndërkombëtarizimin e dijes na u konfirmua edhe nga zv.dekania që mbulon kërkimin shkencor dhe projektet, ndërsa stafi akademik vuri në dukje përvojën me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, si Ministria e Punëve të Brendshme, Unicef, Ambasadat e ndryshme, etj. Gjithashtu, dekani dhe përgjegjësi i departamentit na konfirmuan përgatitjen e lartë të stafit akademik dhe përvojën e gjatë në trajnime dhe ekspertiza.

	<i>Duke u nisur nga përvoja e fortë, departamenti mund të binjakëzohet me departamente simotra nga universitete në vendet e Bashkimit Evropian në fushën e filozofisë dhe fushave të ngjashme, ku të ndërmerren hapa të koordinuara dhe të institucionalizuara, si psh trajnime të certifikuara duale, konferenca, publikime, projekte, etj.</i> Evidenca: 94. Raport mbi veprimtarinë kerkimore shkencore per vitin 2021-2022, 2022-2023, 2023-2024. 95. Raport Vjetor departamenti i filozofise viti akademik 2023-2024. 96. Raport Vjetor Viti akademik 2022. 105. Te dhena per aktivitet e kerkimit shkencor te realizuara.
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Siç shkruhet në kriterin 1 të këtij standardi, departamenti ka një përvojë të gjatë në organizimin e konferencave dhe veprimtarive shkencore, të cilat ndihmojnë pedagogët dhe studentët në arritjen e objektivit të kerkimit shkencor. Në takimin e stafin akademik u përmend dy konferenca periodike që njësia bazë organizon në bashkëpunim me institucione partnere, ku njëra i kushtohet Ditës Ndërkombëtare të Filozofisë dhe tjetra ditës së etikës. <i>Rekomandojmë hartimin e botimeve konkrete pas përfundimit të konferencave dhe veprimtarive të tjera shkencore në nivel të ngjashëm, të cilat do të pasuronin literaturën respektive në shqip dhe do të vijë në ndihmë të studentëve dhe të studiuesve të tjerë.</i> Evidenca: 94. Raport mbi veprimtarinë kerkimore shkencore per vitin 2021-2022, 2022-2023, 2023-2024. 95. Raport Vjetor departamenti i filozofise viti akademik 2023-2024. 96. Raport Vjetor Viti akademik 2022. 105. Te dhena per aktivitet e kerkimit shkencor te realizuara.
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi i studimit formon tek studentët njohuri të thelluara dhe i përgatit ata me aftësi profesionale për drejtimin dhe lehtësimin e shërbimeve sociale. Kjo realizohet nëpërmjet praktikës profesionale, kontakteve me ekspertë të fushës falë orëve të hapura, trajnimeve të ofruara, aksesit në konferenca dhe aktivitete të tjera kerkimore-shkencore në dhe temës së diplomës në studimin e rasteve të veçanta.

	<i>Rekomandojmë koordinim më frytdhënës me zyrrën e karrierës dhe alumnit, me qëllim që studentët të jenë të përditësuar me trajnime të nevojshme dhe aftësi të tjera që do t'i lehtësojnë ata në tregun kombëtar të punës. Gjithashtu, rekomandojmë nxitje të studentëve për t'u përfshirë në mobilitetet e programit Erasmus+ për sa i përket programeve semestrale dhe praktikave të punës për studentët alumni, të cilat do të aftësonin studentët në tregun ndërkombëtar të punës. Këto të dëshmojnë me informacion të organizuar në akreditimet e ardhshme.</i> Evidenca: 94. Raport mbi veprimtarinë kerkimore shkencore për vitin 2021-2022, 2022-2023, 2023-2024. 95. Raport Vjetor departamenti i filozofisë viti akademik 2023-2024. 96. Raport Vjetor Viti akademik 2022. 105. Te dhëna për aktivitetet e kerkimit shkencor të realizuara.
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Kriteri nuk i përket këtij programi studimi duke qenë se ky i fundit nuk rregullohet nga ndonjë Urdhër i veçantë. Megjithatë, bashkëpunimi që DPPS ka me Urdhërin e punonjësit social në kuadrin e një programi studimi mund të ravijëzojë ide dhe propozime të veçanta ndërdepartamentare së bashku me DF, ide të cilat prekin tregun e punës në fushat e përafërta me punën sociale. Evidenca: - Urdhëri i punonjësve socialë https://urdhriipunonjesvesociale.al/
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Kriteri nuk i përket këtij programi studimi i cili nuk është profesion i rregulluar.
Konkluzione	<i>Programi i studimit garanton njohuri të thelluara dhe aftësi profesionale në përgatitjen e studentit për tregun e punës por edhe për vazhdimin e ciklit të tretë të studimeve i cili mbetet fokusi kryesor i programit të studimit me theks dimensionin teorik.</i>

	<i>Rekomandohet bashkëpunime të tjera që përmes ndërkombëtarizimit të dijes dhe shkëmbimit të përvojave do të lehtësojnë studentët në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve në programin e studimit janë leksionet, seminarat, orët e hapura, detyrat e kursit, esetë, projektet dhe praktikatat profesionale pranë institucioneve partnere, publike dhe jo publike. Këto përmbushin ndërthurjen e orëve teorike dhe praktike, të cilat së bashku me sjelljen e përvojave përmes orëve të hapura synojnë të kompletojnë tek studentët kapacitetet e nevojshme profesionale. <i>Gvj konstaton një mangësi të manualit të praktikës profesionale.</i> Evidenca: 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023. 2.10. Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxënës dhe provimet. 82. Lista e Marreveshjes për praktiken mesimore profesionale 94. Raport mbi veprimtarinë kërkimore shkencore për vitin 2021-2022, 2022-2023, 2023-2024. 99. Rregullore e Programit të studimit Master I shkencave në

	<i>Filozofi Sociale</i> <i>105. Te dhena per aktivitet e kerkimit shkencor te realizuara. 108-109 dhe 113-114. Programe 2022-2024</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	DF respekton diversitetin e studentëve dhe aplikon akses të barabartë në dije përmes formave të larmishme të mësimdhënies, të cilat janë paraprakisht të parashikuara në rregullore, në planin mësimor si dhe në programet lëndore të përditësuara. Këto janë format klasike të mësimdhënies (leksione dhe seminare) por edhe forma inovative si analiza teksti, reflektim dhe metodë në panel, diskutime me në qendër studentin, simulime, studime rasti, projekte në grup, mjete audio-vizive, debate sokratike, retorikë dhe prezantim me elementë logosin etosin, patosin. Në takimin që patëm me studentët, ata u shprehen të kënaqur për sa i përket cilësisë së mësimdhënies. <i>Megjithatë rekomandohet që kjo të evidentohet si matje në anketën përkatëse mbi kënaqësinë e studentëve për cilësinë e mësimdhënies.</i> <i>Rekomandohet hartimi i një manuali të veçantë në departament në lidhje me format e mësimdhënies, të pasuruar nga përvojat dhe propozimet e stafit akademik, si dhe nga propozimet e studentëve.</i> Evidenca: <i>91 dhe 12 (dok.shitesë). Plan Mesimor</i> <i>92. Plani i Punes.</i> <i>99. Rregullore e Programit te studimit Master I shkencave ne Filozofi Sociale.</i> <i>108-109 dhe 113-114. Programe 2022-2024</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	UT dhe FSHS mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, duke krijuar platforma të veçanta trajnimi, siç është psh Qendra për Zhvillimin Profesional në nivel IAL. Në takimin me dekanin dhe përgjegjësin e departamentit na u konfirmua se si rregull FSHS krijon kushtet e nevojshme nëse departamenti kërkon trajnime për përmirësimin e mëtejshëm të kompetencave didaktike. Evidenca: <i>1.20. Vendimi i Senatit Akademik për ngritjen e Qendrës Virtuale të Trajnimit dhe Zhvillimit Profesional.</i>

	1.25. <i>Plani strategjik i UT për zhvillimin e personelit akademik 2023-2028.</i> 2.20. <i>Politika e FSHS për zhvillimin profesional të personelit akademik.</i> <i>Qendra për Zhvillimin Profesional në UT</i> https://unitir.edu.al/qender-virtuale-e-trajnitimit-dhe-zhvillimit-profesional/
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	DF ka në përbërjen e tij një staf të kualifikuar dhe me përvojë në mësimdhënie (8 anëtarë). Një pjesë e tyre ka përfunduar studimet universitare dhe pasuniversitare në universitetet prestigjioze të vendeve të Bashkimit Evropian, duke qenë i gatshëm të ofrojë pranë UT përvojën e fituar. Përveç titujve dhe gradave, një pjesë e pedagogëve disponon përvoja trajnimi të certifikuara, duke i bërë ata ndihmues në procesin e përmirësimit të metodave të mësimdhënies, nxënies dhe kultivimit të mendimit kritik, në respekt të lirisë akademike. <i>Megjithatë, siç theksohet në kriterin 2 të këtij standardi rekomandohet hartimi i një manuali të veçantë në departament në lidhje me format e mësimdhënies, të pasuruar nga përvojat dhe propozimet e stafit akademik, si dhe nga propozimet e studentëve.</i> Evidenca: 2.18. <i>Informacion për politikën e burimeve njerëzore dhe vlerësimin e personelit.</i> 2.20. <i>Politika e FSHS për zhvillimin profesional të personelit akademik 2020.</i> 24. <i>Aktivitete dhe kualifikimi shkencor i stafit 5 vitet e fundit (dok.shitesë)</i> 73. <i>CV e Pedagoqeve të Jashtëm</i> 91 dhe 12 (dok.shitesë). <i>Plan Mesimor</i> 92. <i>Plani i Punes.</i> 107. <i>Aneksa të Akreditimit në Master Shkencor Filozofi Sociale</i> 108-109 dhe 113-114. <i>Programe 2022-2024</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe	DF vlerëson periodikisht performancën e pedagogut për sa i përket përcjelljes së dijes me anën e metodave të mësimdhënies. Për këtë ndihmojnë mendimet e vjelura nga studentët përmes pyetësorëve që organizon NJSBC-ja por edhe diskutimet e lira me studentët dhe përfaqësuesit e tyre në këshillat studentorë. Nga takimet me studentët na u transmetuan vlerësime pozitive për punën e pedagogëve në metodat e mësimdhënies dhe

duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	transparencën që ata shfaqin me studentët. Evidenca: 1.6. Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT. 99: Rregullore e Programit të studimit Master I shkencave në Filozofi Sociale.
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	UT, FSHS dhe njësitë e NJSBC dhe Karrierës kujdesen për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Siç u përmend në kriterin 3 të këtij standardi, UT ka çelur Qendrën për Zhvillimin profesional, ku pedagogët mund të trajnohen me aftësi të mëtjshme të mësimdhënies. Gjithashtu, nevojat për trajnime të mëtjshme shprehen nga përgjegjësi i departamentit në dekanat dhe dekani kujdeset për menaxhimin e kërkesave në fjalë. Evidentimi i problematikave në lidhje me cilësinë e mësimdhënies realizohet nga NJSBC, e cila procedon më pas me komunikimin e autoriteteve përgjegjëse në dekanat. Edhe sektori i karrierës kujdeset për bashkëpunime me institucionet partnere dhe me biznesin, të cilat mund të propozojnë pasurimin e metodave të mësimdhënies, kryesisht në kontekstin e praktikës profesionale. <i>Rekomandohet organizimi i veprimtarive shkencore në lidhje me didaktikën në fushën përkatëse, në bashkëpunim me njësi akademike por edhe me palët e tjera të interesuara.</i> Evidenca: 1.11. Manuali i cilësisë. 1.13. Manuali i vlerësimit të performancës të personelit akademik. 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë. 1.2. Statuti i UT <https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2019/08/Statuti_2018.pdf> 1.24. Strategjia institucionale për mesimdhënie 2022-2027 1.3. Rregullore e UT <https://unitir.edu.al/rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022/> 1.6. Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT. 1.6.1. Rregullore për organizimin dhe funksionimin e njërive të sigurimit të brendshëm të cilësisë në UT 2022. 2.3. Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Sociale 98. Rregullore Bachelor në Filozofi.

	99. Rregullore e Programit të studimit Master I shkencave në Filozofi Sociale. 101. Strategjia e zhvillimit të Departamentit të Filozofisë 20-2024. -- Qendra për Zhvillimin Profesional në UT <https://unitir.edu.al/qender-virtuale-e-trajnimet-dhe-zhvillimit-profesional/>			
Konkluzione	UT garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve. Nisur nga përvoja e rëndësishme e DF me metodat e mësimdhënies rekomandohet diskutimi i metodave inovative në veprimtari shkencore të dedikuara, si dhe në kontakt me pedagogë dhe studentë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e testimit dhe e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale-shkencore përcaktohen nga dokumentacioni në fuqi i UT dhe njësive përbërëse, si statuti, rregulloret e UT, FSHS, DF, ajo e programit të studimit, rregullorja e NJSBC, ku kjo e fundit si njësi matën edhe operacionalizimin e parashikimeve normative në raportet periodike që harton. Kontrolli i dijeve përbëhet nga vlerësimi i vazhduar (detyrat e kursit, esetë, prezantimet, punët në grup) dhe nga provimi përfundimtar. Këto parashikohen paraprakisht në programet lëndore të pedagogut, të miratuara më pas në departament. Evidenca: 1.3. Rregullore e UT <https://unitir.edu.al/rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022/>. 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023. 98. Rregullore Bachelor në Filozofi. 99. Rregullore e Programit të studimit Master I shkencave në Filozofi Sociale.

	<i>108-109 dhe 113-114. Programme 2022-2024</i>			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive në fillim të çdo moduli, në respekt të programeve lëndore, të rregullores së programit të studimit dhe të dokumentacionit normativ të UT. Kjo na u konfirmua edhe në takimin me studentët të cilët nuk evidentuan problematika apo shqetësime të veçanta. Evidenca: 99. Rregullore e Programit të studimit Master I shkencave në Filozofi Sociale. 108-109 dhe 113-114. Programme 2022-2024			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Sipas rregullores së UT testimi i dijeve bëhet me shkrim, me gojë ose i kombinuar. Mënyrat dhe format e kontrollit të dijeve përcaktohen nga rregulloret dhe në programet lëndore. DF krijon komisione për mbikqyrjen e procesit të provimeve nëse e vlerësojnë një gjë të tillë. <i>Rekomandohet forma të alternuara të vlerësimit të dijes në pyetje multiple choice. Këtu mund të ndihmojë platforma ClearScore e Albanian-American Development Foundation (AADF) me të cilin UT ka edhe një marrëveshje të veçantë.</i> Evidenca: 1.10.1. Marrëveshje bashkëpunimi midis Albanian-American development foundation. 98. Rregullore Bachelor në Filozofi. 99. Rregullore e Programit të studimit Master I shkencave në Filozofi Sociale. 108-109 dhe 113-114. Programme 2022-2024			
Konkluzione	<i>Testimi i njohurive dhe dijeve është i përcaktuar tek dokumentacioni normativ i UT dhe njësive përbërëse të tij. Ai kontrollohet nga DF dhe nga NJSBC-ja përmes formave të vjeljes së mendimeve të studentëve. DF është transparente në informimin e studentëve me format dhe mënyrat e vlerësimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Testimi dhe vlerësimi i njohurive realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet rregulloret e njësisë bazë, përfshirë edhe programet lëndore. Komponentët e vlerësimit në këtë program studimi janë: a) frekuentimi i lëndës, pjesëmarrja aktive, detyra e kursit dhe testi i pjesshëm 30-40% e pikëve totale; b) provimi përfundimtar 60-70% e pikëve totale. Evidenca: 2.10. Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxënit dhe provimet. 98. Rregullore Bachelor ne Filozofi. 99. Rregullore e Programit te studimit Master I shkencave ne Filozofi Sociale. 108-109 dhe 113-114. Programe 2022-2024
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	UT ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Albanian-American development foundation, e cila vë në dispozicion platformën elektronike të vlerësimit ClearScore. Nga takimi me stafin akademik na u konfirmua se nuk aplikohen sisteme elektronike të vlerësimit, diçka që përkundrazi do të ishte e rekomandueshme si formë alterantive atje ku ka hapësirë, për arsye të epokës ku ne jetojmë, në të cilën informacioni digjital është bërë pjesë e pandashme për të gjithë ne. Evidenca: 1.10.1. Marrëveshje bashkëpunimi midis Albanian-American development foundation. 2.10. Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxënit dhe provimet. 108-109 dhe 113-114. Programe 2022-2024
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me bazën ligjore në fuqi (statutin e UT dhe rregulloret e njësive hierarkike UT – FSHS – DF – program studimi), si dhe në respekt të programeve lëndore (silabuseve). Vlerësimi përfundimtar është shumatorja e vlerësimit të vazhduar dhe atij përfundimtar, ku studenti është i informuar paraprakisht për mënyrën e vlerësimit.
	Nga takimi me studentët u shfaq nevoja që disa prej pedagogëve duhet të njoftojnë paraprakisht pikët e vlerësimit të vazhduar, pasi ka patur raste kur ato janë hedhur në fund të korigjimit të provimeve dhe në mungesë dijenie nga studentët.

	Evidenca: 99. Rregullore e Programit te studimit Master I shkencave ne Filozofi Sociale. 108-109 dhe 113-114. Programe 2022-2024
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i vazhduar dhe përfundimtar shoqërohet me komente për identifikimin e gabimeve dhe këshillat e mundshme u konsultohen studentëve në orë të veçanta. Pedagogët kanë orare konsultash me studentët dhe i kanë afishuar ato në zyrat përkatëse. Por nga takimi me pedagogët u evidentua mungesa e kërimit të konsulencës nga studentët. Gjithashtu, nga studentët u konfirmua korrektësia e pedagogëve në shpjegimin e vlerësimit të vendosur, përveç disa rasteve të izoluara ku vlerësimi i vazhduar nuk u komunikohet paraprakisht studentëve, siç përshkruhet në kriterin e mësipërm. <i>Rekomandohet evidentimi i orarit të konsulencave.</i> Evidenca: 1.3. Rregullore e UT <https://unitir.edu.al/rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022/>. 99. Rregullore e Programit te studimit Master I shkencave ne Filozofi Sociale.
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Baza normative e UT parashikon penalitete në raste kopjimi dhe plagjiature, ndërkohë që DF përpiqet që t'i shmangë këto forma për të mos kaluar në penalitete. Pedagogët përpiqen që me anën e konsultimeve dhe të studimeve unike të rastit të shmangin plagjiaturën. <i>Megjithatë, rekomandohet blerja dhe aplimi i programeve antiplagjiature në detyrat e kursit dhe në punimet e diplomave.</i> Evidenca: 1.3. Rregullore e UT <https://unitir.edu.al/rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022/>. 99. Rregullore e Programit te studimit Master I shkencave ne Filozofi Sociale.
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret	Vlerësimi i studentëve bazohet në meritë dhe rezultatet dorëzohen në sekretarinë mësimore brenda afatit të përcaktuar prej 8 ditësh. Përpara dorëzimit të procesverbalit me notat përfundimtare pedagogu hedh vlerësimin në platformën elektronike E-Student.

përkatëse.	Evidenca: 1.3. Rregullore e UT <https://unitir.edu.al/rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022/>. 2.10. Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxënit dhe provimet. 99. Rregullore e Programit të studimit Master I shkencave në Filozofi Sociale.
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studenti ka të drejtën të njihet me vlerësimin dhe të drejtën e ankimit brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve në platformën E-Student. Ata mund të kërkojnë njohjen e tezës së plotësuar të provimit dhe pikëzimin e detajuar. Evidenca: 1.3. Rregullore e UT <https://unitir.edu.al/rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022/>. 2.10. Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxënit dhe provimet. 99. Rregullore e Programit të studimit Master I shkencave në Filozofi Sociale.
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Në rast ankimi, studenti paraqet kërkesë me shkrim tek përgjegjësi i departamentit i cili kryen verifikimet e nevojshme dhe në pamundësi informon në mënyrë hierarkike dekanin. Brenda 48 orëve pas marrjes së informacionit nga përgjegjësi i departamentit, dekani ngre një komision të posaçëm që verifikon me detaje pretendimet e studentit. Komisioni cakton edhe vlerësimin përfundimtar të studentit. Nga takimi me studentët na u konfirmua se praktikisht nuk ka patur raste ankimi dhe se departamenti ka qenë korrekt për mos të patur problematika në lidhje me vlerësimin. Evidenca: 1.3. Rregullore e UT <https://unitir.edu.al/rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022/>. 2.10. Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxënit dhe provimet. 99. Rregullore e Programit të studimit Master I shkencave në Filozofi Sociale.
Konkluzione	DF siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit. Përgatitja normative e departamentit për të qenë korrekt me

	<i>procesin e vlerësimit konfirmohet edhe nga mungesa e precedentëve specifikë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit garanton thellimin e njohurive, të cilat ndihmojnë studentin të shpjegojë dhe interpretojë në mënyrë profesionale fenomene dhe probleme që lidhen me drejtimin dhe lehtësimin e shërbimeve sociale. Paralelisht, thellimi i njohurive në fushën e filozofisë i ndihmon studentët në vazhdimin e ciklit të tretë të studimeve. Programi i studimit garanton gjithashtu zhvillimin e aftësive profesionale, qoftë nëpërmjet orëve praktike (seminare, detyra kursi, kuize) dhe kryesisht nëpërmjet praktikës profesionale. Evidenca: 1 dhe 11 (dok.shitesë). Kuadri konceptual i programit të studimit 91 dhe 12 (dok.shitesë). Plan Mesimor 92. Plani i Punes. 94. Raport mbi veprimtarine kerkimore shkencore per vitin 2021-2022, 2022-2023, 2023-2024. 99. Rregullore e Programit te studimit Master I shkencave ne Filozofi Sociale. 105. Te dhena per aktivitet e kerkimit shkencor te realizuara.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit ofron një gamë lëndësh të lidhura ngushtë me filozofinë dhe filozofinë sociale, me qëllim thellimin e njohurive dhe aftësive profesionale. Kurrikula është veçanërisht me fushën e mësuesisë por edhe me institucionet, tek e cila shkrihet edhe impakti I praktikës profesionale (si psh me Bashkinë Tiranë). Megjithatë, ka vend që në të ardhmen kurrikula të pasurohet me lëndë të cilat mund të ndihmojnë në zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, si fushë e rëndësishme e epokës së sotme. Evidenca:

	82. <i>Lista e Marreveshjes per praktiken mesimore profesionale 91 dhe 12 (dok.shtesë). Plan Mesimor</i> 92. <i>Plani i Punes.</i> 99. <i>Rregullore e Programit te studimit Master I shkencave ne Filozofi Sociale.</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Në takimin e stafin akademik dhe me studentët na u konfirmua se në përfundim të çdo lënde pedagogët mbledhin të dhënat, i analizojnë dhe i shqyrtojnë, për sa i përket kompetencave dhe aftësive që fiton studenti, në harmoni me planin mësimor dhe programet lëndore të miratuara nga departamenti. <i>Rekomandohet dokumentacion verifikues, si për shembull analiza e vlerësimit në përfundim të një lënde/moduli.</i> Gjithashtu, shqyrtimi i arritjes së kompetencave është objekt i analizave periodike në departament si dhe të NJSBC-së. Evidenca: 95. <i>Raport Vjetor departamenti i filozofise viti akademik 2023-2024</i> 96. <i>Raport Vjetor Viti akademik 2022.</i> 108-109 dhe 113-114. <i>Programe 2022-2024</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Programi i studimit synon që mësimdhënien ta realizojë në bazë kompetencash, me qëllim zhvillimin e njohurive të marra në praktikat profesionale. Në këtë aspekt, motivohen studimet e rastit në nivele të ndryshme - kombëtar, komunitar dhe familjar. Gjithashtu, studentët motivohen të ndërmarrin dhe të prezantojnë punë (detyra) në grup. Nëpërmjet këtyre të dyjave metodave, studenti vendoset në qendër të mësimdhënies dhe inkurajohet fryma e bashkëpunimit në menaxhimin e problematikave sociale. Evidenca: 1.24. <i>Strategjia institucionale per mesimdhënien 2022-2027 vendim-nr.24.</i> 2.10. <i>Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxënit dhe provimet.</i> 2.17. <i>Raporte periodike NJSBC 2023, 2024.</i> 78. <i>Kerkimi Shkencor mbi mesimdhënien.</i> 95. <i>Raport Vjetor departamenti i filozofise viti akademik 2023-2024</i> 96. <i>Raport Vjetor Viti akademik 2022.</i> 108-109 dhe 113-114. <i>Programe 2022-2024</i>


Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	DF dhe koordinatori i programit të studimit inkurajojnë stafin PAE dhe PAK të organizojnë orë të hapura, ku të diskutohen tematika aktuale që lidhen me fushën e studimit dhe konkretisht veçantësitë e shoqërisë shqiptare, përfshirë edhe dimensionet kryesore që karakterizojnë sot shoqëritë nën efektin e Globalizmit. <i>Evidenca:</i> <i>4. Praktike e oreve te hapura (dok.shtesë)</i> <i>78. Kerkimi Shkencor mbi mesimdhenien.</i> <i>105. Te dhena per aktivitet e kerkimit shkencor te realizuara.</i>			
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	DF së bashku me stafin akademik nxisin studentët për zhvillimin e ideve novative dhe studimeve të përparuara kërkimore-shkencore. Kjo realizohet përmes punimeve të diplomës nën udhëheqjen e pedagogut si dhe aksesit nëpër projekte dhe në konferencat shkencore. <i>DF, në bashkëpunim me departamente, apo edhe FSHS si njësi kryesore, mund të organizojnë një ditë/javë të caktuar vjetore (panair) ku studentët të ofrojnë ide inovative, ku të parashikohen shpërblime motivuese.</i> <i>Evidenca:</i> <i>1.18. Vendim BA Për miratimin e programit të Grantit per konferenca ndërkombëtare.</i> <i>2.10. Baza rregullatore për mesimdhënien, të nxënit dhe provimet.</i> <i>2.11. Rregullore e Diplomimit FSHS.</i> <i>78. Kerkimi Shkencor mbi mesimdhenien.</i> <i>94. Raport mbi veprimtarine kerkimore shkencore per vitin 2021-2022, 2022-2023, 2023-2024</i> <i>101. Strategjia e zhvillimit te Departamentit te Filozofise 20-2024.</i> <i>105. Te dhena per aktivitet e kerkimit shkencor te realizuara.</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit garanton thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale tek studentët. Rekomandohet pasurim i kurrikulës me njohuri specifike që karakterizojnë shoqëritë bashkëkohore, si dhe vjelja e ideve inovative nga studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Detyrimi përmbyllës i këtij programi studimi sipas rregullores së FSHS (neni 56) është punimi i temës së diplomës, e cila mbrohet pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve që parashikon plani mësimor, para një jurie të posaçme, të propozuar nga përgjegjësi i departamentit dhe të miratuar nga dekani. <i>Evidenca:</i> 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023. 2.11. Rregullore e Diplomimit FSHS. 99. Rregullore e Programit të studimit Master I shkencave në Filozofi Sociale.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Studentëve u vihet paraprakisht në dispozicion informacione dhe udhëzime të nevojshme në lidhje me punimin e diplomës, të cilat gjenden kryesisht në Rregulloren për diplomimin dhe në Manualin e punimit të diplomës e cila rekomandohet t'i bashkangjitet dokumentacionit në rast se ekziston. DPPS dhe stafi akademik asistojnë studentët në procesin e saktësimit të temës përfundimtare dhe udhëheqjen e tij/saj përgjatë të gjithë hulumtimit shkencor. <i>Evidenca:</i> 1.9. Rregullore-për-diplomimin UT. 2.11. Rregullore e Diplomimit FSHS. 99. Rregullore e Programit të studimit Master I shkencave në Filozofi Sociale.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Ky standard nuk lidhet me programin e studimit, pasi ky i fundit parashikon vetëm punim diplome si detyrim përmbyllës.
Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon	Përzgjedhja e temave bëhet nga studentët sipas grup-temave të sugjeruara nga DF dhe miratohet nga ky i fundit. Pas miratimit të temës, pedagogu udhëheqës asiston studentin përgjatë gjithë

studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	hulumtimit shkencor dhe e monitoron atë, sipas standardeve më të larta të kërkimit shkencor. Në përfundim të studimit të temës, udhëheqësi duhet të japë dakordësinë e tij përpara se të procedohet me mbrojtjen e temës. Siç theksohet në kriterin 5 të standardit III.3. <i>rekomandohet blerja dhe aplikimi i programeve antiplagjiature në punimet e diplomave.</i> Evidenca: 2.11. <i>Rregullore e Diplomimit FSHS.</i> 99. <i>Rregullore e Programit të studimit Master I shkencave në Filozofi Sociale.</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Në punimin e diplomës dhe konkretisht përgjatë hulumtimit shkencor DF drejton studentët në ambientet e bibliotekës së FSHS e cila ka një fond modest të literaturës së fundit dhe asaj klasike që lidhen me shkencat sociale. <i>Rekomandohet ndërgjegjësim më eficient që studentët të frekuentojnë bibliotekën.</i> Evidenca: 2.11. <i>Rregullore e Diplomimit FSHS.</i> 2.24. <i>Rregullore e Bibliotekës 2019.</i> 2.26. <i>Buxheti për pasurim të bibliotekës.</i> 2.27. <i>Dokument mbi librat e fundit për bibliotekën.</i> 99. <i>Rregullore e Programit të studimit Master I shkencave në Filozofi Sociale.</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Sipas rregullores së FSHS, DF dhe programit të studimit, studenti vlerësohet me notë 5-10 nëse cilësohet kalues pas mbrojtjes së temës së diplomës përpara jurisë së posaçme. Nota pasqyrohet në procesverbalin përkatës, i cili firmoset dhe dorëzohet në sekretarinë mësimore sipas procedurave në fuqi. Evidenca: 2.9. <i>Rregullore e Sekretarisë Mësimore 2018.</i> 2.11. <i>Rregullore e Diplomimit FSHS.</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të	Sipas parashikimeve normative të UT (statutit dhe rregulloreve), studenti pajiset me diplomën dhe me suplementin e diplomës, të miratuara nga MAS. Diploma dhe suplementi përshkruajnë nielin, përmbajtjen, rezultatet e studimeve të kryera dhe të përmbyllura me sukses nga mjetësi i diplomës.




studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Evidenca: 77. <i>Format i Suplementit të Diplomes së Masterit të Shkencave në Filozofi Sociale</i> 99. <i>Rregullore e Programit të studimit Master I shkencave në Filozofi Sociale.</i>			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Sekretaria mësimore e FSHS ruan dokumentacionin e studentit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ajo mban rregjistër bazë të studentëve me të dhënat personale të tyre, vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, të dhëna mbi diplomën së bashku me suplementin e diplomës, të formatuara këto sipas standardeve shtetërore të Republikës së Shqipërisë. Rregjistri i studentëve plotësohet në formë të shkruar dhe elektronike dhe mbahet në ruajtje të përhershme. Sekretaria mësimore e departamentit përpilon, administron dhe është përgjegjëse për mirëmbajtjen e rregjistrit themeltar (bazë), të shkruar me dorë dhe me kompjuter. Rregjistri themeltar plotësohet me shkrim, pa korigjime dhe nuk ndryshohet për asnjë arsye. Përdorimi dhe përpunimi i të dhënave personale të studentëve bëhet prej sekretarisë mësimore në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto dokumente si dhe procesverbalet e provimit, ruhen pas diplomimit, në arkivën e institucionit dhe më pas sipas ligjit për arkivat. Të dhënat origjinale të studentit i kthehen atij, ndërsa institucioni ruan kopje të njësuar me origjinalin në formë hardcopy dhe elektronike. Evidenca: 1.2. <i>Statuti i UT</i> < https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2019/08/Statuti_2018.pdf > 2.9. <i>Rregullore e Sekretarisë Mësimore 2018.</i>			
Konkluzione	Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm. Rekomandohet shkrimi i manualit të diplomës në nivel departamenti si dhe kontrolli i diplomave përmes programit antiplagjiaturë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë

të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Në funksion të realizimit të mësimdhënies dhe të praktikës profesionale, DF dhe FSHS garantojnë mjedise të përshtatshme që mundësohen nga bashkëpunimi i këtyre njësive me institucionet në të cilat kryhet praktika profesionale. <i>Evidenca:</i> 5. Raport mbi përfitimin nga marrveshjet (dok.shtesë) 82. Lista e Marreveshjes per praktiken mesimore profesionale			
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Ky standard i referohet programit të studimit “Master profesional” dhe nuk i takon programit të studimit “Filozofi sociale” i cili është “Master shkencor”. N/A			
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	N/A			
Konkluzione	-			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																							
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Referuar procedurës së rekrutimit, si dhe asaj të konsultuar gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, i angazhuar në zbatimin e programit të studimit, i plotëson kërkesat ligjore në fuqi. Bazuar në CV e stafit akademik rezulton se ata zotërojnë kualifikimin e duhur akademik për drejtimin e programit, duke mbuluar sipas fushës lëndët dhe modulet e programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave Sociale në përgjithësi dhe në Departamentin e Filozofisë në veçanti. Ndërkohë ngarkesa vjetore mësimore e personelit akademik miratohet me vendim të Senatit Akademik, sipas kuadrit ligjor në fuqi. Personeli akademik i angazhuar siguron mbulimin e ngarkesës mësimore për programin e studimit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, bazuar në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Të dhënat e stafit akademik për program studimi. Në lidhje me titujt dhe gradat e stafit, duke ju referuar të dhënave të Tabelës 6.1, kemi: <table><tr><th rowspan="2">Stafi akademik i programit të studimit</th><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2023 – 2024</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr</td><td>3</td><td>-</td><td>2</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof.As.Dr</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr/PhD</td><td>6</td><td>7</td><td>7</td><td>5</td></tr><tr><td>Dr në proces</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td></tr><tr><td>Msc</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td></tr><tr><td>Total</td><td>10</td><td>7</td><td>10</td><td>5</td></tr></table>	Stafi akademik i programit të studimit	2022-2023		2023 – 2024		PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	3	-	2	-	Prof.As.Dr	1	-	1	-	Dr/PhD	6	7	7	5	Dr në proces	-	-	-	-	Msc	-	-	-	-	Total	10	7	10	5
Stafi akademik i programit të studimit	2022-2023		2023 – 2024																																					
	PAE	PAK	PAE	PAK																																				
Prof.Dr	3	-	2	-																																				
Prof.As.Dr	1	-	1	-																																				
Dr/PhD	6	7	7	5																																				
Dr në proces	-	-	-	-																																				
Msc	-	-	-	-																																				
Total	10	7	10	5																																				

	Evidenca: 2.1 Statuti i Universitetit të Tiranës 1.12 Manuali i Punësimit të Personelit në UT 2.1 Statuti i Universitetit të Tiranës Udhëzim nr. 29, datë 10.09.2018 për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë. 104. Tabela përmbledhëse e akreditimit Master i Shkencave në Filozofi Sociale
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Sipas përcaktimeve ligjore, personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës, kriter i cili plotësohet nga stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi. Referuar tabelës përmbledhëse (tabela nr.12., 12.2, 12.3), GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është personel akademik kryesisht me kohë të plotë dhe përmbush kërkesat ligjore në fuqi përsa i përket kualifikimit. Personeli akademik për këtë program studimi në totale mbulon 1782 orë totale në auditore. Evidenca: 2. Tabelat e RVB-es.
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga IAL, evidencave dhe vizitës në institucion, del në pah se institucioni siguron stabilitetin e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit. Kjo përfshin sigurimin e kontratave të punës dhe garantimin e mbulimit me sigurime shoqërore dhe shëndetësore, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës. Evidenca: Zyra e Burimeve Njerëzore, FSHS; 2.18. Informacion për politikën e Burimeve Njerëzore dhe vlerësimin e personelit; CV e Pedagogëve të Jashtëm.
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me	Sipas vlerësimit në RVB dhe verifikimeve të kryera gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton praktikën e ndjekjes së procedurave të rekrutimit të personelit akademik, në përputhje me kriteret e bëra publike dhe sipas rregullores institucionale, sipas Kodit të Punës, Ligji nr. 80/2015, aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe aktet e brendshme

nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	rregullatore të institucionit. Procedurat e rekrutimit ishin dokumentuar dhe plotësuar në përputhje me Politikat dhe Procedurat e Rekrutimit të Stafit Akademik në Fakultetin e Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës. Kriteret publikohen në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik në “Buletin e Njoftimeve Publike”, nr. 171, datë 01.12.2021, faqet 368-370” në linkun: https://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=60781e9b22ad-4308-aff9-b872eb2b5404 Për të siguruar përzgjedhjen e kandidatëve me kualifikimin e duhur, ngrihet një komision ad hoc, i krijuar nga drejtuesi i njësisë kryesore. Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë: dy anëtarë të përzgjedhur nga drejtuesi i njësisë për të cilën është hapur konkurimi, dy anëtarë të përzgjedhur nga drejtuesi i njësisë kryesore (ku të paktën njëri duhet të jetë pjesë e njësisë bazë për të cilën është hapur konkurimi) dhe një anëtar i caktuar nga rektori. Komisioni ad hoc përgatit dhe aprovon vlerësimin e kandidaturave, duke respektuar procedurat e përcaktuara në “Manualin e Punësimit”. Pasi përfundon procesi i vlerësimit, Rektori miraton emërimin e personelit dhe formalizon marrëdhënien e punës përmes nënshkrimit të kontratës me punëdhënësin, në përputhje me procedurat e rekrutimit për personelin akademik me angazhim të plotë. Evidenca: <i>1.1.2 Manuali i Punësimit.</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Referuar RVB dhe vizitës në institucion, ekspertët konstatojnë se sipas kurrikulës, nuk ka aktivitete laboratorike.
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e	RVJ referuar RVB dhe vizitës në institucion konstaton se IAL ruan informacionin në lidhje me anëtarët e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit në dy njësi të ndryshme.

studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Të dhënat në lidhje me stafin akademik në njësinë e parë mbledhen dhe ruhen pranë njësisë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit (në këtë rast Departamenti i Filozofisë. Në njësinë e dytë, të dhënat në lidhje me stafin, si akademik, ashtu edhe atë drejtues dhe ndihmës mësimor, mbledhen dhe administrohen nga Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, e cila administron dosjet e plota për çdo anëtar të personelit, e cila çdo vit akademik mbledh dhe përditëson të dhënat e personelit akademik, të rekrutuar sipas nevojave të propozuara nga departamenti. Evidenca: 1.12. Manuali për punësimin e personelit në UT. 2.21. Udhëzim për dosjen e pedagogut.
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	GVJ konstaton se Departamenti i Filozofisë ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale. Departamenti gjithashtu ka vënë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale si dhe punimin e diplomës. Evidenca: Lista e Marrëveshjes për praktikën mësimore profesionale.
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	GVJ konstaton se bazuar në Rregulloren e Praktikës, çdo student bashkëpunon me mbikëqyrësin e tij/saj për procesin e praktikës. Me anë të marrëveshjeve të nënshkruara midis institucioneve, mbikëqyrësi ka të drejtë të ketë gjithashtu kontakt të drejtpërdrejtë me institucionin, që studenti ka zgjedhur. Evidenca: Format Ditari Praktike Profesionale Departamenti Filozofisë; Rregullore e Programit të studimit Master i shkencave në Filozofi Sociale.
Konkluzione	GVJ bazuar në raportin e GVB dhe vizitën në institucion ka konstatuar se kriteret e standardit nr. IV.1 janë

	përmbushur plotësisht. • Kështu bazuar në CV e stafit akademik rezulton se ata zotërojnë kualifikimin e duhur akademik për drejtimin e programit, duke mbuluar sipas fushës lëndët dhe modulet mësimore të programit. • Institucioni po ashtu ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit. • RVJ gjithashtu konstaton se IAL ruan informacionin në lidhje me anëtarët e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit. • GVJ konstaton se Departamenti i Filozofisë ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione brenda vendi, por vihet re se mungojnë marrëveshje me institucione jashtë vendi në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale. GVJ konstaton gjithashtu se bazuar në Rregulloren e Praktikës, çdo student bashkëpunon me mbikëqyrësin e tij/saj për procesin e praktikës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Mjediset e Fakultetit të Shkencave Sociale, ku zhvillohet veprimtaria e njësive bazë të Departamentit të Filozofisë, përfshijnë një ndërtesë katërkateshe që ndodhet në Bulevardin Gjergj Fishta. Sipërfaqja totale e godinës është 4,500 m ² dhe përmban 6 salla leksionesh dhe 16 salla seminare. Ajo ka kapacitet për 759 vende për seminarët dhe 747 vende për sallat e leksioneve, të cilat mund të shfrytëzohen në dy turne mësimorë, sipas cikleve të studimit, duke mundësuar dyfishimin e kapaciteteve. Mjediset menaxhohen në mënyrë efikase dhe të përshtatshme për krijimin e kushteve optimale për studentët e programit të studimit Master i Shkencave në "Filozofi Sociale".

	Evidenca: 2.28. Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16.
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Fakulteti i Shkencave Sociale ofron mjedise të përshtatshme për procesin mësimor, duke përfshirë klasa, zyra, auditorë dhe ambiente alternative si këndi i studentëve, i pajisur me teknologji bashkëkohore. Sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me videoprojektorë, ndërsa personeli akademik mbështetet nga zyra e IT-së për pajisje logjistike si laptopë. Evidenca: 2.28. Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16.
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Fakulteti i Shkencave Sociale ofron aparaturat, mjetet dhe mjediset e nevojshme dhe të përshtatshme, në përputhje me natyrën specifike të programit, për të përmbushur kërkesat e moduleve, zhvillimin e aftësive teorike dhe praktike, si dhe realizimin e objektivave formuese të programit të studimit në tërësi. Evidenca: 2.28. Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Fakulteti i Shkencave Sociale, në mbështetje të programit Master i Shkencave në "Filozofi Sociale", siguron mjedise të përshtatshme studimi në bibliotekë, të pajisura me teknologji moderne. Përveç hapësirave për lexim dhe studim, studentët kanë në dispozicion akses në programe profesionale si SPSS, biblioteka digjitale dhe revista shkencore të specializuara, që mbështesin kërkimin dhe thellimin akademik në përputhje me kërkesat e programit të studimit. Evidenca: 2.28. Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16; 2.25.1. Të dhëna të plota për platformat on-line tabela 17.
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar	Zhvillimi i praktikave mësimore për programin Master i Shkencave në "Filozofi Sociale" realizohet në bashkëpunim me institucione dhe organizata shtetërore dhe private, me të cilat Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Departamenti i Filozofisë kanë nënshkruar marrëveshje

nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.	bashkëpunimi. Këto marrëveshje synojnë ofrimin e mundësive për zhvillimin e praktikave profesionale dhe aktiviteteve praktike, në përputhje me kërkesat dhe objektivat e programit të studimit.			
Konkluzione	Evidenca: 3.21 Tabela përmbledhëse me institucionet dhe organizatat bashkëpunuese për praktikat profesionale, (Tabela 5). GVJ bazuar në raportin e GVB dhe vizitën në institucion ka konstatuar se kriteret e standardit nr. IV.2 janë përmbushur plotësisht. • Departamenti i Filozofisë zhvillon veprimtarinë mësimore Master i Shkencave në "Filozofi Sociale" në kampusin e Fakultetit të Shkencave Sociale. • Ambientet mësimore në IAL kishin kompjuterë në bibliotekë dhe auditorët ishin të pajisura me kushte të përshtatshme për realizimin e procesit mësimor. Bazuar në të dhënat mbi evidenca, RVB dhe vizitat në institucion, IAL garanton kapacitete të mjaftueshme për formimin praktik të studentëve në programet e fushës së filozofisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe	GVJ bazuar në RVB e dorëzuar konstaton se literatura e nevojshme për lëndët e zhvilluara është në dispozicion të studentëve në mënyrë fizike (bazuar kjo dhe në vizitën në bibliotekë) ose digjitale në formatin (fiziWdigjital).

njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Evidenca: <i>Programe 2022-2023;</i> <i>Programe 2023-2024.</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	GVJ gjatë shqyrtimit të raportit dhe vizitës në IAL vëren se ka një përpjekje për përditësimin e literaturës me botime të viteve të fundit. <i>GVJ sugjeron përditësimin e syllabuseve sipas VKM, nr. 41, datë 24.1.2018 për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë, si dhe nevojitet që të përditësohet literatura e re edhe në syllabuse.</i> Evidenca: <i>RVB dhe vizita në IAL;</i> <i>Programe 2022-2023;</i> <i>Programe 2023-2024.</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Fakulteti i Shkencave Sociale ofron për studentët mjediset e bibliotekës, e cila përbëhet nga dy salla kryesore: një sallë multimediale e pajisur me kompjuterë dhe një sallë leximi. Biblioteka përfshin gjithashtu fondin e hapur të librave, një zyrë për përpunimin e koleksioneve dhe fondin e mbyllur. Këto ambiente sigurojnë akses të barabartë për të gjithë studentët e programit të studimit. Evidenca: <i>2.24 Rregullore e Bibliotekës;</i> <i>2.25. Të dhëna për bibliotekën;</i> <i>2.26. Buxheti për pasurim të bibliotekës;</i> <i>2.27. Dokument mbi librat e fundit për bibliotekën.</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Studentët dhe pedagogët e Fakultetit të Shkencave Sociale përfitojnë anëtarësim falas në bibliotekë, me akses në katalogë, libra dhe revista në format fizik dhe elektronik. Biblioteka ofron një gamë të gjerë literaturash, përfshirë tekste mësimore bazë, materiale ndihmëse, përkthime, fjalorë, CD-ROM, si dhe revista shkencore, duke mbuluar nevojat e moduleve dhe aktiviteteve mësimore, sipas karakteristikave të programeve të studimit. Fondi i literaturës përditësohet vazhdimisht nëpërmjet blerjeve, dhurimeve, artikujve shkencorë dhe tezave. Gjithashtu, biblioteka depoziton materiale nga konferencat shkencore të pajisura me ISBN/ISSN. Procesi i katalogimit dhe informatizimit realizohet përmes sistemit COBISS. Aktualisht, biblioteka numëron rreth 3,750 tituj dhe 70 poste leximi, të pasuruara me 869 tituj të rinj

	gjatë pesë viteve të fundit. Evidenca: 2.25. <i>Të dhëna për bibliotekën;</i> 2.27. <i>Dokument mbi librat e fundit për bibliotekën.</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Aksesi në bibliotekat online të Fakultetit të Shkencave Sociale është falas dhe siguron mundësi për qasje të barabartë për të gjithë studentët dhe stafin akademik. Ky akses mund të realizohet në çdo kohë dhe nga çdo vend, mjafton përdorimi i kredencialeve përkatëse. Përdoruesit mund të kenë qasje në platformat digjitale përmes lidhjeve të ndryshme, si Biblioteka Online e Universitetit të Tiranës dhe ULibrari në bashkëpunim me Rrjetin Akademik Shqiptar. Përmes një marrëveshjeje me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF), Universiteti i Tiranës ka siguruar një abonim në bibliotekën digjitale JSTOR, e cila ofron një burim të pasur informacioni. JSTOR ka mbi 12 milion artikuj akademikë, 85.000 libra dhe 2 milion dokumente në 75 disiplina të ndryshme. Për të aksesuar burimet, mund të përdorn lidhjet si <u>Biblioteka Online e Universitetit të Tiranës</u> ose <u>ULibrary</u>, të cilat janë pjesë e këtij bashkëpunimi dhe ofrojnë mundësi për kërkime dhe studime të thelluara online. Evidenca: 2.4 <i>Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale, kreu 4, neni 83;</i> https://unitir.edu.al/aksesi-online/ https://unitiredu.sharepoint.com/sites/BibliotekaOnline https://ulibrary.rash.al
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka ofron kompjuterë të pajisur me internet të shpejtë (përmes lidhjes kablllore dhe Wi-Fi), duke siguruar qasje të pakufizuar. Të gjitha programet kompjuterike të nevojshme për mbështetje në studime janë të instaluar dhe në dispozicion të studentëve. Evidenca: RVB; Vizita në bibliotekë; 2.28. <i>Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16.</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me	Orari i shërbimit të bibliotekës është i përshtatur me orarin mësimor dhe me nevojat e studentëve. Biblioteka e Fakultetit të Shkencave Sociale është në dispozicion të studentëve nga e hëna deri të premten, nga ora 8:30 deri në 19:30.

oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Evidenca: <i>RVB; Vizita në bibliotekë.</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Fakulteti i Shkencave Sociale i Universitetit të Tiranës ka një fond të veçantë në buxhetin vjetor për pasurimin e bibliotekës me literaturë të re, i cili bazohet në kërkesat e stafit akademik të paraqitura nga departamenti dhe është parashikuar gjithashtu në buxhetin e këtij departamenti. Bibliotekat e Universitetit të Tiranës organizohen në dy nivele: 1) Biblioteka Qendrore e UT-së dhe 2) Biblioteka e njësive kryesore. Sipas strukturës organizative të Fakultetit të Shkencave Sociale, biblioteka e këtij fakulteti është pjesë e njësive përbërëse të tij. Pasurimi i fondit të bibliotekës me literaturë të re, kryesisht në fushën e filozofisë, realizohet në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të njësisë kryesore. Stafi akademik i Departamentit të Filozofisë harton një plan të detajuar për shtimin e literaturës që mbështet programin e studimit "Bachelor" në Filozofi dhe ia dërgon drejtuesit të bibliotekës dhe Administratorit të njësisë kryesore për miratim. Evidenca: 1.2. Statuti i Universitetit të Tiranës , neni 28 1.3. rregullore-e-universitetit-te-tiranes; 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale, kreu 1, neni 11; 2.24 Rregullore e Bibliotekës; 2.25. Të dhëna për bibliotekën; 2.26. Buxheti për pasurim të bibliotekës; 2.27. Dokument mbi librat e fundit për bibliotekën.
Konkluzione	GVJ bazuar në raportin e GVB dhe vizitën në institucion ka konstatuar se kriteret e standardit nr. IV.3 janë përmbushur plotësisht. • Kështu GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar konstaton se literatura e nevojshme për lëndët e zhvilluara është në dispozicion të studentëve në mënyrë fizike ose digjitale. • Sipas verifikimeve të dokumentacionit kryera nga GVJ, institucioni raporton se ka vënë në dispozicion të studentëve një bibliotekë të pasur, e cila përbëhet nga dy pjesë integrale:

	biblioteka me libra të printuar dhe biblioteka elektronike. • Fondi i Bibliotekës paraqitet në bazën elektronike të të dhënave, si dhe pasurohet vazhdimisht me materiale në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, nëpërmjet blerjeve, shkëmbimeve, dhuratave dhe abonimeve. • Biblioteka ka rregulloren e saj dhe një plan për rritjen cilësore dhe sasiore. Departamentet po ashtu mund të bëjnë kërkesë për blerjen e titujve dhe librave të rinj në lidhje me programin e studimit para fillimit të vitit akademik. Fondi i bibliotekës është i parashikuar në buxhet dhe realizohet me bazë vjetore. <i>GVJ sugjeron përditësimin e syllabuseve sipas VKM, nr. 41, datë 24.1.2018 për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë, si dhe nevojitet që të përditësohet literatura e re edhe në syllabuse.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Fakulteti i Shkencave Sociale ka krijuar një procedurë të organizuar për menaxhimin e informacionit lidhur me studentët dhe aktivitetet e tyre, nga regjistrimi deri në diplomim, përmes sekretarisë mësimore të programit të studimit të ciklit të dytë Master. Të dhënat ruhen dhe administrohen si në format elektronik, ashtu edhe në kopje fizike përmes regjistrave përkatës. Evidenca: 2.9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore 2018.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit	Sipas RVB, dhe vizitës në institucion, Zyra e Burimeve Njerëzore e IAL-së administron dhe mbledh informacionin, dokumentacionin dhe veprimtarinë e personelit akademik, personelit mbështetës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në zbatimin e programit: diplomat, arrijtet akademike, CV-të dhe të gjithë informacionin e nevojshëm.

administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Po ashtu kjo zyrë vë në dispozicion të njërive brenda IAL-së të gjitha statistikave për kryerjen e studimeve, apo kërkimeve të nevojshme për miradministrimin e institucionit apo kurrikulave. Evidenca: 1.7. Rregullore për vlerësimin e performancës në punë personel ndihmës akademik dhe administrativ; 1.8. Rregullore UT për "Mbrotjen, Përpunimin, ruajtjen dhe sigurimin e të dhënave personale; 2.18. Informacion për politikën e burimeve njerëzore dhe vlerësimin e personelit.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Përshkrimi i informacionit dhe dokumentacionit për personelin dhe studentët bëhet në përputhje me ligjin e mbrojtjes së privatësisë dhe rregulloren për "Mbrotjen, Përdorimin, ruajtjen dhe sigurimin e të dhënave personale" të Universitetit të Tiranës. Ky proces është gjithashtu i reflektuar në Programin e Transparencës të Universitetit, i cili përcakton hapat për qasjen në dokumente dhe informacion. Studentët dhe stafi akademik mund të kërkojnë informacion përmes kërkesave të administruara zyrtarisht për ato të dhëna që nuk janë të mbrojtura nga politika e mbrojtjes së të dhënave personale. Universiteti është duke zhvilluar gjithashtu një sistem të ri nëpërmjet platformës e-Albania, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), ku pedagogët dhe studentët mund të aksesojnë dokumente të lidhura me të drejtat e tyre, duke përdorur numrat personalë dhe username të siguruar nga IT. Evidenca: 1.8. Rregullore UT për "Mbrotjen, Përpunimin, ruajtjen dhe sigurimin e të dhënave personale; 1.10. Manual përdorimi i sistemit informatik e-student 2022; https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/04/2020-Programi-i-transparences-i-UT.pdf
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit	Personeli akademik komunikon me studentët përmes emailëve zyrtarë dhe platformës Microsoft Teams, në përputhje me udhëzimet të cilat janë publikuar gjithashtu në faqen zyrtare të Institucionit https://unitir.edu.al/aksesi-online/. Përmes klasave virtuale, studentëve dhe pedagogëve u ofrohet mundësia të ngarkojnë leksionet dhe materialet ndihmëse në seksionin "class

ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	materials". Po ashtu, platforma ofron mundësi për diskutime konstruktive nëpërmjet rubrikave të ndryshme. Studentët mund të shikojnë gjithashtu rezultatet e tyre dhe komentet në rubrikën "Assignment", si dhe vlerësimet në rubrikën "Grades", ku gjithçka mund të verifikohet në mënyrë private. Evidenca: RVB dhe intervista në IAL.			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Fakulteti i Shkencave Sociale ka zhvilluar një sistem të brendshëm për menaxhimin e aktiviteteve, i cili mundëson raportimin në kohë reale përmes platformës të menaxhimit të informacionit. Ky proces realizohet nga personeli ndihmës akademik dhe ai që monitoron mësimdhënien. Raportimi bëhet kryesisht përmes kanaleve të komunikimit zyrtar dhe adresave të dedikuara, duke siguruar që informacioni të arrijë menjëherë te organet drejtuese dhe titullarët. Evidenca: RVB dhe intervista në IAL.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Të dhënat që lidhen me programet e studimit, stafin akademik dhe aktivitetet e ndryshme janë të disponueshme në faqen zyrtare të internetit në dy gjuhë, shqip dhe anglisht, ku jepen informacione të detajuara mbi programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e tjera. Evidenca: Të dhëna nga faqet zyrtare web: https://fshs-ut.edu.al/			
Konkluzione	GVJ është i mendimit se në IAL funksionon në mënyrë efikase sistemi i administrimit të informacionit, që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomim, edhe lidhur me programin e studimit "Master Shkencor" në "Filozofi Sociale". Sistemi i platformave digjitale mundëson formë të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pjanë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Fakulteti i Shkencave Sociale, në bashkëpunim me njësitë bazë të programeve të studimit, përgatit raporte financiare dhe pasqyra të të ardhurave dhe shpenzimeve. Këto dokumente përfshihen në planin buxhetor të institucionit dhe shërbejnë për të garantuar funksionimin e pandërprerë të programeve të ciklit të parë dhe të tjerave në periudha afatmesme trevjeçare, duke mbuluar të paktën një cikël studimi. Raportet financiare shqyrtohen fillimisht në dekanët dhe më pas i përcillen Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit të Universitetit të Tiranës për miratim. <i>Evidenca:</i> 2.32. <i>Buxheti afatmesëm FSHS 2022-2025;</i> 2.33. <i>Buxheti i FSHS 2023.pdf</i> 2.30. <i>Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit, per FSHS (Tabela 18).</i>

Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Raporti financiar ofron një pasqyrë të detajuar të të gjitha angazhimeve financiare, përfshirë pagat, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e ambienteve dhe pajisjeve mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën, pasurimin me literaturë, si dhe aksesin në bibliotekat online. Gjithashtu, në këtë raport përfshihen edhe të ardhurat e gjeneruara nga kontratat për Kërkim dhe Zhvillim, të siguruara përmes projekteve të ndryshme ku Fakulteti i Shkencave Sociale dhe pedagogët e tij, përfshirë edhe ata të Departamentit të Filozofisë, kanë qenë partnerë. Evidenca: <i>Raport financiar 2023</i> 2.30. <i>Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit, per FSHS (Tabela 18).</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Bazuar në RVB, në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë për auditimin e aktivitetit financiar, rezulton se institucioni kryen auditim periodik lidhur me përmbushjen e objektivave financiar. Fakulteti përgatit çdo vit raporte dhe pasqyra financiare sipas kërkesave ligjore, duke dokumentuar të ardhurat, shpenzimet dhe shpërndarjen e burimeve. Raporti financiar, i hartuar nga administratorja, përfshin të dhëna mbi të ardhurat nga tarifat e shkollimit dhe kontributet e tjera financiare. Në Raportin e Auditimit jepen pasqyrat financiare, politikat kontabël dhe ato të sistemit të kontrollit të brendshëm, një informacion i detajuar mbi shkallën e plotësimit të objektivave strategjike të institucionit për rritjen e cilësisë së mësimdhënies, konsolidimin e procesit kërkimor, si dhe ndarjen e burimeve financiare. Evidenca: <i>Raport financiar 2023;</i> 2.34. <i>Raport auditit FSHS.</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton	Sipas RVB e dokumentacionit përkatës të institucionit lidhur me

deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	procedurat e mbështetjes financiare të programit të studimit, njësia bazë, përgjegjëse e programit, harton kërkesat e nevojat financiare lidhur me realizimin e tij. Departamenti i Filozofisë dhe Fakulteti i Shkencave Sociale përpilojnë dhe paraqesin analizën e realizimit të buxhetit të vitit të mëparshëm, duke u fokusuar në sigurimin e fondeve për zbatimin efektiv të programeve të studimit. Procesi i përgatitjes së buxhetit buxhetit diskutohet dhe miratohet në nivel departamenti dhe dekanati, për t'u dorëzuar më pas për shqyrtim dhe aprovimin përfundimtar nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit të Universitetit të Tiranës. Evidenca: 2.32. Buxheti afatmesëm FSHS 2022-2025; RVB. Propozime për projekt-buxhetin vjetor të Departamentit të Filozofisë 2023-2024 Të dhëna mbi koston e programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të një cikli të plotë studimi.			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Shkencave Sociale garantojnë stabilitet financiar dhe burime të mjaftueshme për të mbështetur zhvillimin e vazhdueshëm të institucionit. Këto kapacitete sigurojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike dhe fuqizimin e veprimtarive institucionale për të ardhmen. Evidenca: RVB dhe vizita në institucion.			
Konkluzione	GVJ është i mendimit se IAL garanton mbështetjen financiare, e nevojshme për të siguruar mbarëvajtjen e procesit mësimor-kërkimor dhe mbështetjen e studentëve, në kuadër të realizimit të programit të studimit që ofron e përmbushjes së objektivave të tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullore.	Në bazë të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", IAL, bazuar në Statutin dhe Rregulloret e brendshme, zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve, nga hyrja në dalje. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, që lidhet me programin "Master Shkencor" në "Filozofi Sociale", GVJ konstaton se në IAL janë hartuar për zbatim një sërë dokumentash themelore në nivel institucional (Statuti dhe Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Sociale), ku udhëzohen ndër të tjera edhe procedurat e politikave të pranimit të studentëve, të ecurisë e përfundimit të studimeve, si dhe të diplomimit të tyre. Këto rregullore mbulojnë të gjitha aspektet akademike, përfshirë edhe programin e studimit "Master i Shkencave" në "Filozofi Sociale". Pranimi i studentëve çdo vit akademik realizohet në përputhje me kuotat dhe kriteret e miratuara për secilin program studimi, të cilat publikohen në faqen zyrtare të institucionit dhe bazohen në procedurat dhe udhëzimet e përcaktuara nga MAS. Numri dhe shpërndarja e studentëve bëhet sipas kategorive të përcaktuara në tabelën përkatëse të kuotave të pranimit, duke përfshirë studentët për programin e dytë të studimeve, transferimet dhe kategoritë e veçanta. Procesi i diplomimit zhvillohet në përputhje me rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e diplomimit të Fakultetit të

	Shkencave Sociale, duke garantuar një trajtim të qartë dhe të strukturuar për të gjithë studentët. Evidenca: 1.2. Statuti i Universitetit të Tiranës 2018, neni 89 dhe neni 90; 1.3. Rregullore e Universitetit të Tiranës 2022; 1.9. Rregullore për diplomimin UT; 1.21. Vendim SA nr.7 dt 13.03.2024 me kuotat cikli II 2024-2025; 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023; Kuotat e Pranimit brenda vendit 2023-2024; Rregullore e Programit të studimit Master i shkencave në Filozofi Sociale, Kreu VI.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	GVJ, referuar dokumentacionit ligjor të institucionit dhe evidencave të praktikave të zbatuara gjykon se politikat dhe procedurat, që ndiqen nga hyrja në dalje e studentëve, si ato të pranimi, frekuentimit, ankimimit, të vlerësimit të arritjeve akademike, garantojnë trajtimin e drejtë dhe të barabartë të studentëve. Procedurat dhe politikat akademike sigurojnë të drejta të barabarta për të gjithë kandidatët dhe studentët. Të drejtat dhe detyrimet përcaktohen në Rregulloren e UT, Rregulloren e FSHS dhe Rregulloren e Programit të Studimit. Universiteti garanton gjithashtu barazi dhe transparencë në pranime, bazuar në Urdhrin Nr. 112, datë 05.05.2024, të publikuar në webin i IAL-së: 🔗 Kriteret e pranimi, kuotat dhe tarifat e studimit https://unitir.edu.al/kriteret-e-pranimi-kuotat-dhe-tarifet-e-studimit/ Ndërsa Departamenti ngre një komision ad hoc për renditjen e kandidatëve, duke siguruar paanësi dhe objektivitet. Të gjitha kriteret dhe kuotat publikohen paraprakisht për një proces transparent në ciklin e dytë të studimeve. Evidenca: Rregullore e programit të studimit, Kreu VIII; 1.22. Kriteret e pranimi 2024-2025.
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në	Senati Akademik e miraton dhe e bën publike në faqen zyrtare të Universitetit të Tiranës, para fillimit të çdo viti akademik, listën e kriterëve për përzgjedhjen e kandidatëve, në përputhje me Statutin e Universitetit të Tiranës.

programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Evidenca: https://unitir.edu.al/kriteret-e-pranimit-kuotat-dhe-tarifat-estudimit/ https://fshs-ut.edu.al/njoftim?id=1547
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	GVJ, nisur nga dokumentacioni përkatës e takimet me studentët e programit, konstaton se institucioni jep informacion të vazhdueshëm për kandidatin dhe studentin lidhur me kriteret, procedurat e pranimit dhe procesin e transferimeve të studimeve, të cilat i bën publike në webfaqen zyrtare të Universitetit, Fakultetit dhe rrjetet sociale të tyre. Institucioni ka hartuar e ka bërë publike për të interesuarit një sërë rregulloresh, të përgjithëshme dhe të posaçme, që u referohen këtyre procedurave si dhe hapave të ecurisë së procesit mësimor e përparimit të studentëve përgjatë kursit të studimit, detyrimeve lidhur me frekuentimin e leksioneve, seminareve, punëve laboratorike e praktikës mësimore, kontrollit dhe vlerësimit të dijeve, formave të provimit e rasteve të ankimimit, përgatitjes e mbrojtjes së diplomës, të drejtave e detyrave të studentëve përgjatë zhvillimit të ciklit mësimor, etj. Evidenca: 1.2. Statuti i Universitetit të Tiranës 2018, neni 89 dhe neni 90; 1.3. Rregullore e Universitetit të Tiranës 2022; 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023; Kuotat e Pranimit brenda vendit 2023-2024; Rregullore e Programit të studimit Master i shkencave në Filozofi Sociale.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin përkatës si dhe nga takimet në institucion me pedagogët e studentët e programit “Master Shkencor” në “Filozofi Sociale”, GVJ konstatoi se IAL dhe strukturat e tij, në faqen e tij të internetit, publikon kërkesat e përgjithshme e të veçanta të programit përkatës, ndërsa të disponueshme janë për këtë qëllim edhe mediat sociale të IAL-së. Gjithashtu, mjete të tjera publiciteti nga ana e institucionit janë edhe ditët e informimit dhe këshillimit të karrierës, njoftimet e publikuara në ambjentet e Fakultetit nëpërmjet sekretarisë mësimore dhe nëpërmjet Zyrës së Karrierës. etj.

	Evidenca: RVB; intervista në IAL; https://unitir.edu.al/?s=kriteret+cikli+i+dyte https://fshs-ut.edu.al/njoftim?id=1672
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Bazuar në RVB dhe në dokumentacionin e IAL-së, konstatohet se institucioni ndjek politika mbështetëse për të gjithë studentët që janë pjesë e pakicave apo shtresave të marginalizuara. Përpara fillimit të çdo viti akademik, Fakulteti i Shkencave Sociale informon publikun mbi kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit në programet e studimit, duke përfshirë ato për kandidatët me aftësi të veçanta, pakicat, grupet e marginalizuara, apo ata shtete të tjera.
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Në mbështetje të ecursë e përparimit akademik të studentëve, Fakulteti i Shkencave Sociale ka gjithashtu një politikë bursash për shtresat në nevojë. Të gjitha këto informacione publikohen në faqen zyrtare të Universitetit të Tiranës: https://unitir.edu.al/?s=kriteret+cikli+i+dyte,
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	në faqen e Fakultetit të Shkencave Sociale: https://fshs-ut.edu.al/?s=kriteret+e+pranimit dhe në njoftimet zyrtare: https://fshs-ut.edu.al/njoftim?id=1694. Gjithashtu, informimi bëhet edhe përmes faqes zyrtare të fakultetit në Facebook, si dhe përmes njoftimeve të afishuara në ambientet e fakultetit, sekretarisë mësimore dhe Zyrës së Karrierës.
	Evidenca: RVB; intervista në IAL; https://unitir.edu.al/?s=kriteret+cikli+i+dyte https://fshs-ut.edu.al/njoftim?id=1672
Konkluzione	Departamenti i Filozofisë, Fakulteti i Shkencave Sociale ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura, që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve, nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. Institucioni i publikon dhe i bën të aksesueshme për publikun kriteret e pranimit të studentëve, sipas programeve të studimit të shpallura

	<i>nga departamentet, bashkë me detyrimet përkatëse përgjatë procesit mësimor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Institucioni u ofron studentëve informacion të detajuar mbi kriteret dhe procedurat për përparimin e tyre akademik dhe kalimin nga një vit në tjetrin. Ky informacion komunikohet në mënyra të ndryshme, në përputhje me rregulloret e UT, FSHH dhe DF. Çdo student, me fitimin e statusit akademik, pajiset me një adresë elektronike zyrtare, e cila shërben si një nga kanalet kryesore të komunikimit me institucionin. Ndërkohë, organizimi i vitit akademik, datat e semestrave dhe sezoni i provimeve shpallen nga Rektori dhe publikohen në faqen zyrtare të universitetit dhe të fakultetit për akses të lehtë nga studentët. Departamenti dhe fakulteti publikojnë gjithashtu oraret mësimore në ambientet e institucionit, duke përfshirë detaje mbi lëndët, sallat dhe pedagogët përkatës. Çdo pedagog përgatit syllabusin e lëndës, ku specifikohen literatura, metodat e vlerësimit dhe format e komunikimit me studentët. Përmes Sektorit të Informacionit dhe Teknologjisë, studentët pajisen me kredencialet e tyre për sistemin informativ TIMS, ku mund të regjistrohen, të ndjekin progresin akademik, të prenotojnë provime dhe të marrin shërbime të ndryshme administrative. Gjithashtu, studenti mund të aplikojë në sekretari për marrjen e vërtetimeve apo listave të notave dhe krediteve. Përveç postës elektronike, institucioni përdor numrat e telefonit të studentëve për njoftime urgjente. Komunikimi me stafin akademik realizohet edhe përmes orareve të pritjes të përcaktuara nga departamenti. Studentët e masterit mbështeten nga koordinatori për marrëdhëniet me studentët dhe përgjegjësi i DF, të cilët ofrojnë asistencë dhe këshillim për çështje akademike dhe administrative.

	Evidenca: <i>Rregullore e Programit të studimit Master I shkencave në Filozofi Sociale.</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Sekretaria mësimore udhëzon studentët mbi kriteret dhe procedurat për njohjen e kualifikimeve të mëparshme, duke u bazuar në statutin e Universitetit të Tiranës dhe rregulloren për transferimet akademike. Ky informacion shpërndahet përmes faqes zyrtare të universitetit, stendave të njoftimeve në fakultet dhe rrjeteve sociale. Për të lehtësuar aksesin në informacion, studentëve u vihet në dispozicion një broshurë e detajuar, e cila përmban referenca ndaj akteve rregullative të FSHS dhe DF. Gjithashtu, platforma elektronike e universitetit (<i>unitir.edu.al</i>) mundëson komunikim të shpejtë dhe efikas me zyrat përkatëse të shërbimeve. Një tjetër burim informacioni dhe asistence për studentët është bashkëpunimi me koordinatorin akademik dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës në FSHS, të cilat ofrojnë mbështetje për çështje akademike dhe orientim profesional. Evidenca: <i>Statuti i Universitetit të Tiranës , nenet 108-113;</i> <i>Rregullorja e Universitetit të Tiranës, 2022 kreu III;</i> <i>Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale;</i> <i>Rregullore e programit të studimit.</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Departamenti i Filozofisë informon studentët mbi procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive në programin e studimit MSc “Etika në institucione dhe lidërsip”, duke u mbështetur në dokumentet dhe burimet e mëposhtme: • Statuti i Universitetit të Tiranës • Rregullorja e Brendshme e UT • Rregullorja e Brendshme e FSHS • Rregullorja e Brendshme e programit MSc “Etika në institucione dhe lidërsip” • Broshura e DF • Komunikimi i drejtpërdrejtë me pedagogët dhe syllabus-i i çdo lënde Në orën e parë të çdo lënde, studentët njihen me komponentët e vlerësimit dhe peshën e secilit prej tyre. Syllabus-i përmban përshkrimin e lëndës, objektivat, rezultatet e të nxënës,

	metodologjinë e mësimdhënies dhe detyrimet akademike të studentëve, si dhe kriteret e vlerësimit. Vlerësimi i studentëve bazohet në pjesëmarrjen dhe angazhimin në leksione e seminare, punime krijuese, ese dhe analiza me literaturë, të cilat kanë një peshë të caktuar në vlerësimin total, sipas programit të lëndës. Këto kriteret janë të miratuara dhe të përcaktuara qartë në syllabus. Për lehtësimin e aksesit në informacion, programet e lëndëve mund të ngarkohen edhe në platformat online, si Microsoft Teams. Evidenca: <i>Rregullorja e Universitetit të Tiranës, 2022, nenet 41, 42, 45, 46;</i> <i>Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale;</i> <i>Rregullore e programit të studimit, kreu V;</i> <i>Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit.</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Departamenti i Filozofisë (DF) udhëzon studentët e programit MSc "Filozofia Sociale" mbi kriteret dhe procedurat e përgatitjes së punimit të diplomës dhe procesin e diplomimit që në fillim të vitit të parë të studimeve. Koordinatori i programit i orienton studentët në zgjedhjen e temës së diplomës, duke i inkurajuar të mbështeten te përvojat e tyre profesionale, objektivat e tyre të karrierës dhe aftësitë e fituara gjatë masterit, si dhe të marrin në konsideratë perspektivat e punësimit në këtë fushë. Në muajin e dytë të semestrit të vitit të dytë, pasi janë familjarizuar me lëndët e atij viti, studentët nisin procesin e përzgjedhjes së temës së diplomës në përputhje me fushën e tyre akademike. Koordinator i ofron një model orientues të punimit, ndërsa hartimi dhe mbështetja akademike zhvillohen nën udhëzimin e pedagogut mentor. Evidenca: <i>Rregullore për diplomat e ciklit të dytë të studimeve.</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të	Departamenti i Filozofisë dhe koordinatori i programit MSc "Filozofia Sociale" kanë një rol të vazhdueshëm në informimin dhe orientimin e të interesuarve për këtë program studimi. Ky proces nis që me maturantët, duke i inkurajuar të zgjedhin filozofinë, si fushën e tyre të studimit, duke theksuar faktin se departamenti ofron të tre ciklet e studimeve universitare dhe akademike.

interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Gjithashtu, promovimi i masterit zhvillohet në mënyrë më të detajuar me studentët e vitit të tretë të Bachelor-it në Filozofi, duke i ndihmuar të krijojnë një lidhje midis profilit të tyre akademik dhe mundësive që ky program ofron për të ardhmen e tyre profesionale. Për më tepër, informimi realizohet përmes publikimeve dhe pasqyrit të aktiviteteve akademike e shkencore, që organizohen në kuadër të këtij masteri. Koordinatori luan një rol kyç në këtë proces, duke e promovuar programin përmes kanaleve të ndryshme mediatike dhe rrjeteve sociale, si ato të Departamentit të Filozofisë, ashtu edhe personale, për të arritur një audiencë më të gjerë dhe për të ofruar një pasqyrë të qartë mbi mundësitë që ofron ky program. Evidenca: <i>Rregullore e Shërbimit të Karrierës 2020;</i> <i>Politikat e marketingut;</i> https://fshs-ut.edu.al/ https://facebook.com/departamentiifilozofiseUT			
Konkluzione	GVJ konstaton se IAL ka një dokumentacion të plotë e të hollësishëm si dhe realizohet praktikisht informimi i të interesuarve e studentëve edhe përsa i përket programit "Master Shkencor", mbi etapat dhe elementët e procesit të përparimit akademik, deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Informimi për programin Master Shkencor në "Filozofi Sociale" zhvillohet përmes tre shtyllave kryesore: 1. Për studentët e filozofisë – Procesi i informimit nis që në vitin e parë të Bachelor-it dhe shoqëron studentët gjatë gjithë ciklit të tyre akademik, duke u bërë pjesë e këshillimit të karrierës dhe orientimit profesional. 2. Për studentët e tjerë të FSHS – Informimi ofrohet përmes

	sesioneve të dedikuara brenda auditorëve, si dhe përmes ftesave në aktivitete të ndryshme të organizuara nga ky master në bashkëpunim me departamente të tjera të fakultetit. Kjo ndodh kryesisht gjatë vitit të tretë të Bachelor-it, kur studentët janë më të prirur për të planifikuar vazhdimin e studimeve të tyre. Për publikun e gjerë dhe studentët e universiteteve të tjera – Përdoren një sërë mjetesh promovuese për të rritur ndërgjegjësimin dhe interesin për këtë program studimi, duke përfshirë: • Publikime të vazhdueshme në faqet zyrtare dhe rrjetet sociale mbi aktivitetet dhe eventet e komunitetit të këtij masteri. • Broshura informuese. • Informacione të përditësuara në faqen elektronike të FSHS. • Studentët që kryejnë praktika profesionale (internshipe) ndajnë informacion mbi masterin në institucionet shtetërore dhe private ku angazhohen. • Ditët e Hapura dhe Panairi i Punës, ku masteri promovohet drejtpërdrejt tek studentët e interesuar. • Bashkëpunimi me Zyrën e Këshillimit të Karrierës, e cila ofron udhëzime për vijimësinë akademike dhe profesionale. • Promovimi i rrjetit ALUMNI dhe historive të tyre të suksesit në karrierë. Evidenca: RVB; https://fshs-ut.edu.al/ https://facebook.com/departamentiifilozofiseUT
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në fillim të çdo lënde ose moduli, pedagogu i informon studentët lidhur me përmbajtjen e kursit dhe aktivitetet që do të zhvillohen gjatë semestrit, duke u bazuar në statutin e Universitetit të Tiranës dhe në programin mësimor (syllabusin) përkatës. Përpara nisjes së leksioneve, gjatë ditëve të orientimit, Departamenti i Filozofisë në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës dhe Jetës Studentore organizojnë takime informuese me

	studentët. Gjatë këtyre takimeve, studentëve u prezantohet Guida e Studentit. Kjo guidë përmban informacion të detajuar mbi procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, mënyrën e vlerësimit të studentëve, mundësitë për punësim pas studimeve dhe shumë aspekte të tjera të rëndësishme të jetës akademike. Ajo u vihet në dispozicion studentëve që në vitin e parë dhe mund të konsultohet sa herë që është e nevojshme. Koordinatori dhe mentori mbajnë kontakte të rregullta dhe në formë të ndryshme me studentët, për t'i udhëzuar në mënyrë që ata të përfitojnë sa më mirë nga e drejta për informim, gjë që ndihmon në përparimin e tyre akademik dhe në rritjen e transparencës gjatë gjithë procesit mësimor. Evidenca: <i>Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit; Guida e studentit https://fshs-ut.edu.al/njoftim?id=1764</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Që në takimin e parë, koordinatori i programit prezanton mundësitë që ofron masteri për zhvillim profesional dhe karrierë, duke përfshirë shembuj suksesi nga ALUMNI dhe këshilla për lidhjen e temës së diplomës me interesat e tregut të punës. Broshura e Studentit përmban informacion të detajuar për këtë mbështetje. Universiteti organizon gjithashtu “Auditore të Hapura Studentore” me ekspertë nga institucione publike, biznesi dhe OJF, që shpesh çojnë në punësime konkrete. Për më tepër, Specialistja e Këshillimit të Karrierës informon studentët mbi mundësitë e punësimit dhe ofron trajnime për aplikime të suksesshme. Materialet udhëzuese digjitale dhe seminarët e hapura të organizuara nga Departamenti i Filozofisë e plotësojnë këtë mbështetje për orientimin profesional të studentëve. Evidenca: https://fshs-ut.edu.al/?p=8147 <i>Tabelë përmbledhëse të aktiviteteve të organizuara nga Departamenti i Filozofisë.</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e	Studentët marrin informacione të vazhdueshme nga sekretaria mësimore dhe koordinatori i programit për çështjet mësimore, logjistiken dhe infrastrukturën. Të gjitha njoftimet e rëndësishme shpallen në faqen zyrtare të fakultetit, faqen e departamentit dhe

procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	në ekranet elektronike të Fakultetit të Shkencave Sociale. Megjithëse ekzistojnë mekanizma të vendosur për informimin e studentëve, integriteti dhe profesionalizmi i personelit akademik janë të domosdoshme për sigurinë dhe saktësinë e informacionit që u jepet studentëve. Fakulteti i Shkencave Sociale respekton lirinë akademike të pedagogëve, por gjithashtu siguron që ata të përmbushin përgjegjësitë e tyre për të informuar studentët. Ky aspekt diskutohen shpesh në nivelin e fakultetit dhe departamentit. Evidenca: <i>Rregullore e programit të studimit, Kreu III;</i> <i>Vendim për caktimin e koordinatorit të programit të studimit.</i>			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Të gjitha strukturat që kontribuojnë në realizimin e programit të studimit, përfshirë strukturat drejtuese dhe personelin akademik të Departamentit të Filozofisë, personelin ndihmës akademik, sekretarinë mësimore, zyrën e informacionit, zyrën e karrierës dhe strukturat më të larta drejtuese të fakultetit, ndjekin politikën e "dyerve të hapura" dhe janë gjithmonë të gatshme për të mbështetur studentët në çdo aspekt të jetës së tyre studentore. Evidenca: <i>Rregullorja e Programit të Studimit, Kreu III</i> <i>Rregullorja e Sekretarisë Mësimore</i> <i>Rregullorja e Zyrës së Këshillimit për Karrierën</i> <i>Shërbimi i Karrierës – Fakulteti i Shkencave Sociale (fshs-ut.edu.al)</i>			
Konkluzione	<i>IAL vë në dispozicion të studentëve një informacion të plotë, të detajuar dhe lehtësisht të arritshëm mbi përmbajtjen e programit të studimit, objektivat formues e strukturën e tij, si edhe orientues mbi mundësitë e punësimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë qim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222 43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Nga vizita dhe biseda e GVJ me Zyrën e Sekretarisë Mësimore, u konstatuan se procesi i regjistrimit të studentëve dhe mbajtja e statistikave për studentët dhe të diplomuarit kryhet në përputhje me procedurat përkatëse dhe rregulloren e Sekretarisë Mësimore. Kjo rregullore përshkruan me hollësi rregullat dhe detyrat e organizimit dhe funksionimit të procesit. Sekretaria mban statistika vjetore për numrin e studentëve dhe të diplomuarve në programin "Master i Shkencave" në "Filozofi Sociale", të cilat ruhen si në format elektronik në databazën e sekretarisë, ashtu edhe në regjistra të printuar. Evidenca: <i>Rregullorja e Sekretarisë Mësimore:</i> https://fkhs-ut.edu.al/rreth-fakultetit/arkiva-ligjore.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Nga njohja e GVJ me dokumentacionin në Zyrën e sekretarisë mësimore rezulton se ajo disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre. Gjithashtu, në procedurat që kryen, Zyra ka edhe detyrimin për të dokumentuar rastet kur studenti mund të tërhiqet nga programi që ndjek, të largohet para përfundimit të tij, apo të mos e përfundojë me sukses vitin akademik. Këto të dhëna statistikore raportohen pranë njësisë përgjegjëse institucionale; Departamenti i reflekton të dhënat në raportimet vjetore e hartimin e planit strategjik. Evidenca: <i>Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i> <i>Studimi i Tregut të Punës 2022</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	GVJ, gjatë vizitës në institucion konstaton se të dhënat statistikore të studentëve që menaxhohen nga Sekretaria Mësimore, janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Në dokumentacionin përkatës evidentohet se Zyra e Sekretarisë Mësimore disponon të dhëna statistikore të plota për studentët, bazuar në kërkesat e rregullores që disiplinon veprimtarinë e saj. Departamenti, në analizat e rregullta vjetore u referohet këtyre statistikave për të analizuar nivelin e cilësinë e regjistrimit e diplomimit të studentëve të programit. Të gjithë të dhënat në lidhje me studentët ruhen në databazën e sistemit të brendshëm. Ky informacion është i besueshëm dhe mund të merret vetëm përmes një kërkesë të formuluar me

	shkrim. Evidenca: <i>RVB: Rregullore e Sekretarisë Mësimore.</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Bazuar në dokumentacioni përkatës, rezulton se institucioni ka hartuar politika dhe procedura praktike për monitorimin dhe mirëfunksionimin e njësive përbërëse administrative. Nëpërmjet auditimeve të brendshme, vlerësohet dokumentacioni dhe saktësia e informacionit, që lidhet me studentët. Këto auditime, të realizuara nga grupet e punës të ngritura për këtë qëllim, synojnë evidentimin e kontrollin e zbatimin të ligjshmërisë për çështjet sa më sipër. Ato bazohen në rregulloret përkatëse të institucionit dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe i shërbejnë sigurimit të cilësisë në mënyrë të vazhdueshme në njësitë përbërëse të tij. Evidenca: <i>Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT; Rregullore për vierësimin e performancës në punë të personelit ndihmësadministrativ.</i>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Bazuar në takimin me drejtuesin e njësisë bazë, Departamentit të Filozofisë, që ofron programin “Master Shkencor”, si dhe në RVB, konstatohet përgjegjësia lidhur me progresin në vazhdimësi të programit. Njësia harton raporte periodike analitike mbi ecurinë e procesit mësimor, cilësinë në hyrje e dalje të studentëve, shkallën e punësimit, bashkë me masat në funksion të përmirësimit të këtyre treguesve. Të dhënat e fundit tregojnë se shumica e studentëve kanë cilësi në dalje të barabartë ose më të lartë se në hyrje. Sipas studimit të tregut të punës 2022, 44% e të diplomuarve pas masterit janë të punësuar. Njësia mban gjithashtu kontakte me Alumni për të ndjekur ecuritë e karrierës dhe për t’i ftuar në aktivitete kualifikuese. Evidenca: <i>Analiza vjetore e punës së Departamentit të Filozofisë 2020-2021; Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe në dalje;</i>

	<i>Të dhëna tabelore përmbledhëse për punësimin real të studentëve;</i> <i>Studimi i tregut për statusin e punësimit të studentëve dhe të diplomuarve;</i> <i>Studimi i tregut të punës 2022.</i>			
Konkluzione	<i>Nëpërmjet Zyrës së sekretarisë mësimore pranë institucionit, në përputhje me rregulloren, mbledhen, administrohen, ruhen dhe përditësohen të dhënat statistikore të studentëve. Njësia kryesore dhe ajo bazë hartojnë raporte periodike analitike lidhur me ecurinë e procesit mësimor e treguesit cilësorë të tij, si dhe me masat për përmirësimin e mëtejshëm të objektivave të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	<i>Përfaqësimi i studentëve në proceset vendimmarrëse dhe administrative të Universitetit të Tiranës është i siguar nga Statuti i UT-së, Rregullorja e zgjedhjeve dhe akte të tjera rregullatore të institucionit dhe fakulteteve. Studentët janë të pranishëm në organet drejtuese dhe vendimmarrëse, si Senati Akademik, Bordi i Administratës, Këshillat Studentore në nivel fakulteti dhe universiteti, komisionet dhe grupe pune, duke kontribuar me idetë dhe sugjerimet e tyre. Ata gjithashtu mund të ushtrojnë funksionin e vëzhguesit në çdo proces zgjedhor, duke inkurajuar pjesëmarrjen aktive në jetën demokratike të universitetit dhe duke i integruar mendimet e tyre për përmirësimin e akademizmit dhe demokracisë së institucionit.</i> <i>Studentët e Filozofisë kanë qenë aktivë në këto procese zgjedhore, duke përfaqësuar dhe drejtuar Këshillin Studentor të Fakultetit të Shkencave Sociale dhe duke kontribuar si vullnetarë pranë KIZ në zgjedhjet e vitit 2020. Këshillat Studentore janë organizata të pavarura që mbrojnë interesat e studentëve të UT-së në të gjitha programet e studimit. Anëtarët e këtyre këshillave zgjidhen çdo dy vjet nga vota e studentëve të UT-së ose njësisë të</i>

	tij. Rregullat për procesin e votimit janë të përcaktuara qartë në rregulloren përkatëse të zgjedhjeve. Evidenca: Statuti i Universitetit të Tiranës 2018, neni 129-137; Rregullore e Universitetit të Tiranës, 2022, neni 861; Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale, kreu VI; Rregullore për zgjedhjet e Këshillave të Studentëve në Universitetin e Tiranës.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Nga takimi me studentët e programit “Master Shkencor” bazuar në RVB, GVJ konstaton se institucioni vlerëson dhe mbështet organizmat studentorë të pavarur, veprimtaria e të cilave sanksionohet edhe në Statutin e Rregulloren e tij. Këshillat studentore inkurajohen të rrisin aftësitë organizative dhe administruese, të bashkëpunojnë me organet drejtuese të njësisë kryesore në përmirësimin e nivelit mësimor e kërkimor-shkencor, të lehtësojnë zhvillimin e aktiviteteve jashtëshkollore të studentëve e shërbimet ndihmëse për ta, etj. Këshillat e studentëve janë gjithashtu organizime të pavarura që përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e studentëve të Universitetit të Tiranës në të gjitha programet e studimit. Ata kanë mandat dyvjeçar dhe përzgjidhen nëpërmjet votës së lirë të studentëve në nivel universiteti ose njësie kryesore, sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren përkatëse të zgjedhjeve. Universiteti i Tiranës garanton përfshirjen e studentëve në vendimmarrje, konsultim dhe vlerësim të proceseve akademike. Kjo realizohet përmes: Përfaqësimit të tyre në organet kolegjiale vendimmarrëse; Mbështetjes së organizimeve studentore të pavarura; Pjesëmarrjes në proceset e vlerësimit të mësimdhënies, pedagogëve dhe lëndëve. Studentët marrin pjesë në grupet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë dhe kontribuojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e procesit mësimor dhe akademik. Evidenca: Statuti i Universitetit të Tiranës (2018), nenet 129–137; Rregullorja e Universitetit të Tiranës (2022), neni 86; Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Sociale, Kreu VI; Rregullorja për zgjedhjet e Këshillave të Studentëve në UT;

	<i>Manuali i Cilësisë dhe Manuali i Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik.</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributit të tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Bazuar në RVB dhe intervista me studentët, ata luajnë një rol aktiv në përmirësimin e metodave të mësimdhënies dhe përmbajtjes së programeve të studimit, përmes një bashkëpunimi të vazhdueshëm me pedagogët. Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Shkencave Sociale e nxisin dhe e mbështesin këtë përfshirje të studentëve në mënyrë të vazhdueshme. Departamenti i Filozofisë siguron pjesëmarrjen e studentëve në procesin e rishikimit dhe zhvillimit të programeve. Në takimet periodike që organizohen nga departamenti, studentët japin sugjerime dhe bëjnë propozime konkrete, si për shembull: shtimin e praktikave profesionale ose organizimin e seminareve shtesë jashtë atyre të parashikuara në planin mësimor. Evidenca: <i>Tabela përmbledhëse e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Departamentit të Filozofisë për praktikën mësimore.</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Departamenti i Filozofisë ka përcaktuar në rregulloren e programit të studimit procedurat për vlerësimin e studentëve, duke përfshirë mundësinë për ankimim dhe rishikim të rezultateve nga pedagogët përgjegjës të lëndëve. Çdo provim ka një datë të caktuar për shpalljen e rezultateve dhe studentët kanë të drejtë të ankohen nëse nuk janë të kënaqur me rezultatin. Vlerësimi është i hapur dhe i drejtë, dhe studentët mund të ankohen për rezultatet e provimit. Ankesa duhet të dorëzohet me shkrim te përgjegjësi i departamentit brenda 48 orëve nga shpallja e rezultetit. Nëse ka një gabim që mund të korrigjohet, përgjegjësi i departamentit, së bashku me komisionin e provimit, mund të bëjnë korrigjimin. Nëse nuk mund të arrihet një zgjidhje në këtë nivel, çështja kalon tek Dekani, i cili, brenda 48 orëve, formon një komision ad-hoc për të shqyrtuar ankesën dhe për të vendosur nëse duhet të ndryshohet rezultati ose të zhvillohet një provim i ri. Evidenca: <i>Rregullorja e programit të studimit Master në Filozofi; Statuti i Universitetit të Tiranës.</i>
Konkluzione	<i>GVJ është i mendimit se në Departamentin e Filozofisë që ofron programin "Master Shkencor", bazuar edhe në Rregulloren në fuqi, studentët përfshihen dhe angazhohen në procesin këshillues</i>

	<i>dhe vendimmarrës për të e tërhequr sugjerimet e vërejtjet për ecurinë e përparimin e procesit mësimor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Universiteti i Tiranës ka krijuar një sistem të integruar informacioni për të siguruar që studentët të kenë akses në të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje me programet e studimit, procesin mësimor, rregulloret e brendshme të institucionit, procedurat përkatëse dhe aktivitete të tjera akademike. Fakulteti i Shkencave Sociale ofron shërbimin e informacionit për studentët përmes Specialistës së Karrierës dhe zyrës së informacionit. Aktivitetet e Specialistës për Këshillim Karriere janë në përputhje me statutin e universitetit. Faqja zyrtare e internetit të Fakultetit të Shkencave Sociale (https://fshs-ut.edu.al/) ofron informacion të detajuar për aktivitetet e zhvilluara nga departamentet, përfshirë ato të Filozofisë, dhe përditëson të dhëna të rëndësishme për studentët, stafin dhe palët e interesuara. Gjithashtu, informacione janë në dispozicion përmes programit të transparencës në faqen e Universitetit të Tiranës (https://unitir.edu.al/?s=programi+i+transparences). Institucioni është gjithashtu aktiv në rrjetet sociale dhe përdor e-mail zyrtar dhe platformën Teams për komunikim të brendshëm. Evidenca: <i>RVB; Intervista në IAL;</i> <i>2.22.Rregullore e Zyrës së Këshillimit për Karrierë 2021;</i> <i>2.23.Politika për mbështetjen për studentët dhe strukturat e tyre organizative;</i> https://fshs-ut.edu.al/

	https://unitir.edu.al/?s=programi+i+transparences
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Nga biseda me përfaqësues të Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës në institucion dhe nga dokumentacioni përkatës, GVJ konstaton se kjo njësi e posaçme, që ka si mision të rrisë mundësitë dhe aftësitë e studentëve e diplomantëve për të përmirësuar cilësinë e edukimit, të potencialit e aftësive të tyre për tregun e punës, organizon në mënyrë periodike një sërë aktiviteteve. Në Rektorat ka një zyrë të veçantë që merret me informimin e studentëve dhe publikut në përgjithësi, e quajtur Drejtoria e Marrëdhënieve me Studentët dhe Marrëdhëniet me Publikun. Informacionet e nevojshme bëhen të disponueshme në forma të ndryshme si udhëzues, rregullore, fletëpalosje, procedura etj., të cilat mund të gjenden në sekretari dhe u ofrohen studentëve. Në Fakultetin e Shkencave Sociale (, informacionet e rëndësishme për aktivitetet akademike dhe njoftime të tjera të fakultetit shpallen vazhdimisht përmes ekraneve të instaluar. Për të mbështetur studentët e rinj, FSHS dhe departamenti përditësojnë dhe publikojnë broshura informative dhe sisteme, të cilat përmbajnë informacione të rëndësishme për programin e studimit, infrastrukturën, stafin akademik, jetën studentore, si dhe të dhëna të tjera të vlefshme që ndihmojnë studentët të integrohen në fakultet. Gjithashtu, stafi akademik është i disponueshëm për studentët në lidhje me çdo çështje, që ka të bëjë me procesin mësimor dhe programin e studimit, dhe ofron orë konsultimi për të asistuar studentët. Evidenca: 2.23. Politika për mbështetjen për studentët dhe strukturat e tyre organizative; https://unitir.edu.al/marredheniet-mestudentet-dhe-karriera https://fshs-ut.edu.al/?page_id=7093
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar	Nga biseda në institucion e dokumentacionit përkatës, konstatohet se përpara fillimit të vitit akademik pasardhës, titullarët, e njësisë kryesore e bazë, përfaqësuesit e Zyrës për Çështjet Studentore dhe Këshillimit të Karrierës së institucionit organizojnë takime informuese me studentët, si të nivelit Bachelor, ashtu edhe Master. Edhe studentët e programit “Master Shkencor” në “Filozofi Sociale” janë informuar, në takimet e rregullta me

informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	përgjegjësin e Departamentit e anëtarë të stafit pedagogjik, mbi programin, kalendarin akademik, mentorin akademik dhe mbikëqyrësin e praktikës, rregulloren, mënyrën e komunikimit e bashkëpunimit me lektorët, çështje të përgatitjes së diplomës, të praktikës mësimore, etj Fakulteti i Shkencave Sociale ka krijuar një sistem të veçantë për informimin, këshillimin dhe mbështetjen e studentëve në lidhje me procesin mësimor dhe çështje të tjera të rëndësishme. Ky sistem përfshin shërbime të ofruara nga struktura të tilla si Shërbimi ndaj Studentëve dhe Koordinatori i Programit. Për më tepër, FSHS ofron mbështetje nëpërmjet Specialistës për Këshillimin e Karrierës, e cila siguron vazhdimisht: Këshillim për karrierën dhe mundësi për vende pune; Informacione për mundësi praktikash profesionale; Informacione për trajnime dhe workshope; Mundësi punësimi; Specialistja për Këshillimin e Karrierës është e disponueshme për studentët nga e hëna deri të premten, në orarin 8:00 - 16:30. Shërbimi i Karrierës i Fakultetit të Shkencave Sociale (fshs-ut.edu.al) bashkëpunon me institucione dhe organizata të ndryshme, përfshirë ato shtetërore, organizata profesionale, si dhe sektorin e biznesit, për të siguruar mundësi praktike për studentët, përmes trajnimeve, konkurrseve, internshipeve dhe mundësive të tjera punësimi. Evidenca: 2.22. Rregullore e Zyrës së Këshillimit për Karrierë 2021; 2.23. Tabela e mundësive për praktikë profesionale dhe punësim për studentët dhe të diplomuarit; Studimi i tregut të punës.
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Sipas RVB e dokumentacionit përkatës, evidentohet se Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës pranë IAL disponon të dhëna statistikore mbi punësimin e të diplomuarve edhe të Departamentit të Filozofisë. Zyra, në bashkëpunim me njësitë kryesore dhe ato bazë, është në komunikim të vazhdueshëm me organizmat, institucionet apo kompanitë për akses të studentëve në tregun e punës; marrëveshjet me institucione publike dhe private për realizimin e praktikave profesionale u kanë hapur rrugë edhe mundësive të punësimit të studentëve në këto institucione, pas diplomimit. Specialistja e Këshillimit të Karrierës ndihmon studentët pas

	përfundimit të studimeve, duke mbledhur, përpunuar dhe ruajtur informacion mbi nivelin dhe cilësinë e punësimit të të diplomuarve. Ajo siguron që këto të dhëna të jenë në dispozicion të studentëve, si dhe organeve dhe autoriteteve përkatëse. Pas diplomimit, Specialistja e Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore kontakton të diplomuarit përmes email-it, telefonit dhe rrjeteve sociale, duke hartuar raporte mbi gjendjen e punësimit të tyre. Evidenca: 2.22. Rregullore e Zyrës së Këshillimit për Karrierë; 1.26. Studimi i tregut të punës UT 2022; Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve; 1.26. Studimi i tregut të punës 2022.			
Konkluzione	GVJ është i mendimit se IAL ka hartuar dokumentacion përkatës dhe zbaton, nëpërmjet njësive të posaçme, procedura të orientimit e këshillimit të studentëve, ndjekjes e adresimit të problematikave të tyre gjatë procesit akademik, por edhe të orientimit e asistences për akses në tregun e punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin	Institucioni ka ndërtuar procese të qarta vetëvlerësuese, për të siguruar dhe përmirësuar cilësinë në bazë të fushës së studimit. Kështu në nenin 103 të Ligjit për Arsimin e Lartë 2015, përcaktohet

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	se institucionet e arsimit të lartë janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Strukturat dhe funksionimi i njësisë së sigurimit të cilësisë brenda institucioneve përcaktohen në statutin e tyre. Në përputhje me këtë ligj dhe standardet e cilësisë, Universiteti i Tiranës ka implementuar një sistem të konsoliduar për sigurimin e cilësisë, që përfshin masat, veprimtaritë dhe mekanizmat për vlerësimin dhe garantimin e cilësisë së aktiviteteve akademike, administrative dhe financiare. Vlerësimi i cilësisë realizohet çdo 6 vjet. Ky proces mund të jetë i përgjithshëm ose pjesor, dhe ai realizohet në rang të institucionit dhe njësive përkatëse. Në nivel të Universitetit të Tiranës, veprimtarinë për sigurimin e cilësisë e ushtron Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë. Po ashtu, në nivel fakulteti, Fakulteti i Shkencave Sociale ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), e cila funksionon në përputhje me parashikimet ligj. Evidenca: 1.12. Statuti 2018 (i Universitetit të Tiranës, Kreu X); 2.12. Vendim për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FSHS; 1.6. Rregullore e njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FSHS.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Mekanizmat përgjegjës janë zhvilluar nga struktura e NJSBC-së. Këto përfshijnë monitorimin periodik të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik, si dhe anketime me studentë për stafin akademik dhe lëndët e programit. Për të përmbushur detyrimet që dalin nga kriteret dhe standardet e sigurimit të cilësisë, si dhe objektivat e Njësisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në nivel institucional, Fakulteti i Shkencave Sociale ka emëruar individë përgjegjës nga çdo departament për të koordinuar procesin e sigurimit të cilësisë dhe për të bashkëpunuar me Zyrën e Sigurimit të Cilësisë në nivel institucional. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është një strukturë e krijuar në nivel institucional, sipas statutit të Universitetit të Tiranës, dhe ka si qëllim vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë së aktiviteteve të universitetit, si dhe të veprimtarive të stafit akademik, administrativ, studentëve dhe komponentëve të tjerë. Sipas statutit të Universitetit të Tiranës. Njësia ka autonomi në veprimtarinë e saj dhe mundësi të plota për të

Gye

	aksesuar të dhënat e institucionit; ajo organizon, në bashkëpunim me njësitë përkatëse, aktivitetet për kontrollin dhe sigurimin e cilësisë brenda institucionit. Evidenca: <i>Statuti i Universitetit të Tiranës, Kapitulli X, Neni 139;</i> <i>Përshkrimi i veprimtarisë së Njësisë së Sigurimit të Cilësisë;</i> <i>Paketa e Instrumenteve të Cilësisë.</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies, Fakulteti i Shkencave Sociale ka krijuar mekanizma matës dhe vlerësues për vlerësimin e programeve të studimit, duke përfshirë takime, sondazhe dhe anketa me studentët. NJSBC ka përgatitur një set pyetjesh, që janë shpërndarë në mënyrë anonime tek studentët, ndërsa të dhënat e mbledhura analizohen dhe rezultatet e tyre komunikohet. Për të siguruar cilësinë, në nivel fakulteti realizohet vlerësimi i performancës së stafit akademik, duke marrë parasysh cilësinë e zhvillimit të programeve të studimit në kërkimin shkencor dhe kontributet për institucionin. Përgjegjësit e departamenteve, në fund të vitit akademik, plotësojnë formularët për vlerësimin e stafit akademik; gjithashtu vlerësohet edhe aktiviteti shkencor i stafit përmes botimeve dhe pjesëmarrjes në aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Përgjegjësit e departamenteve gjithashtu analizojnë aktivitetin administrativ të pedagogëve, duke vlerësuar korrektësinë në kryerjen e detyrave, shërbimet ndaj studentëve dhe respektimin e afateve kohore. Në përfundim të këtij procesi hartohen raporte dhe analiza të të dhënave të dalë nga vlerësimi, të cilat bëhen pjesë e raporteve vjetore të departamentit/fakultetit dhe evidentojnë problematikat dhe rrugët e mundshme për përmirësimin e cilësisë. Evidenca: <i>1.14. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë;</i> <i>2.15. Të dhëna për NJSC (tabela 24) dhe GVB;</i> <i>Të dhëna për aktivitetet e kërkimit shkencor të realizuara;</i> <i>Raport Vjetor Departamenti i Filozofisë, viti akademik 2023-2024;</i> <i>Raport Vjetor Viti akademik 2022.</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e	Universiteti i Tiranës, përmes Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë dhe në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, harton dhe zbaton politikën e vlerësimit të cilësisë, sipas Rregullores për Sigurimin e Cilësisë, Manualit të Cilësisë dhe Rregullores së NJSBC-së në nivel

vlerësimit.	fakulteti. Ky proces ka për qëllim ndjekjen e procedurave të parashikuara për vlerësimin dhe garantimin e standarteve të programeve të studimit. Dokumentet përkatëse përcaktojnë modalitetet dhe periudhën e monitorimit të cilësisë, ndërsa politikat e vlerësimit të brendshëm të cilësisë koordinohen në nivel institucional dhe sigurojnë bashkëpunimin e aktorëve të brendshëm të institucionit. Rezultatet e vlerësimit publikohen në faqen zyrtare të Fakultetit të Shkencave Sociale. Evidenca: <i>1.11. Manual i Cilësisë;</i> <i>Rregullore e njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FSHS.</i>				
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Fakulteti i Shkencave Sociale dhe departamentet përkatëse ndjekin një strategji të strukturuar dhe përdorin mjete të përshtatshme për vlerësimin e vazhdueshëm të cilësisë në të gjitha dimensionet e veprimtarisë së programeve të studimit, me qëllim rritjen e standardeve akademike. Në funksion të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë - veçanërisht në raste të tilla, si procesi i akreditimit - institucioni garanton një menaxhim efektiv të vetëvlerësimit dhe transparencë të plotë ndërmjet të gjitha strukturave institucionale, duke përfshirë njësinë kryesore dhe atë bazë. Ky bashkëpunim i ngushtë ndërmjet aktorëve institucionalë nxit përmirësimin profesional të stafit akademik dhe përforcon cilësinë e mësimdhënies. Evidenca: <i>Strategjia e Zhvillimit të FSHS 2018-2023;</i> <i>Strategjia e zhvillimit të Departamentit të Filozofisë;</i> <i>Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale;</i> <i>Raport periodik i NJSBC (ose raport vjetor i NJSBC).</i>				
Konkluzione	<i>Në përfundim, institucioni rezulton se ndjek një politikë të sigurimit të cilësisë në përputhje me këtë standard duke përmbushur kriteret si ndërtimi i proceseve të qarta vetëvlerësuese, për të siguruar dhe përmirësuar cilësinë në bazë të fushës së studimit. Këto karakterizohen nga ekzistenca e mekanizmave monitorues, përfshirja e studentëve dhe transparenca.</i> <i>GVJ sugjeron që IAL, përmes mekanizmave të vlerësimit dhe analizimit të rezultateve, të inkurajojnë përhapjen e praktikave më të mira dhe të mbështesin personelin akademik në përpjekjet e tij për përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor.</i>				
Shkalla e përmbushjes së	<table><tr><td>Nuk</td><td>Përmbushet</td><td>Përmbushet</td><td>Përmbushet</td></tr></table>	Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet
Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet		

standardit	përmbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në përmbushje të këtij kriteri, institucioni ka themeluar NJSBC-në, e cila është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Shkencave Sociale synojnë të sigurojnë një nivel të lartë cilësie në të gjitha fushat e veprimtarisë së tyre – nga mësimdhënia, te kërkimi shkencor dhe ofrimi i shërbimeve akademike e administrative – duke shfrytëzuar në mënyrë efikase kapacitetet ekzistuese dhe duke punuar për përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve, në përputhje me zhvillimet në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë. Për të arritur këto synime, institucioni ka ngritur struktura të brendshme për sigurimin e cilësisë dhe merr pjesë rregullisht në procese të vlerësimit të jashtëm. Gjithashtu, ai mbështet dhe bashkëpunon me aktorë të jashtëm, si Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, e cila – në bazë të Ligjit 80/2015, neni 104, pika 5 – organizon Sondazhin Kombëtar të Studentëve, një instrument kyç për vlerësimin dhe avancimin e cilësisë në arsimin e lartë. Evidenca: 1.2. Statuti i Universitetit të Tiranës, kreu X, neni 14; 1.11. Manuali i Cilësisë; Manuali i Vlerësimit të përformancës së personelit akademik i UT-së; Rregullore e njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FSHS.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm	Për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga standardet e sigurimit të cilësisë dhe objektivat e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në nivel institucional, Fakulteti i Shkencave Sociale ka caktuar përfaqësues të posaçëm nga çdo departament. Këta përfaqësues luajnë rolin e koordinatorëve të cilësisë brenda fakultetit dhe bashkëpunojnë ngushtë me strukturat përkatëse në nivel universiteti.

të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	NJSBC është ngritur në përputhje me Statutin e Universitetit të Tiranës dhe ka për detyrë të vlerësojë dhe monitorojë standardet e cilësisë në të gjitha aspektet e veprimtarisë institucionale – akademike, administrative dhe ndihmëse, përfshirë kontributin e stafit dhe studentëve. Statuti parashikon mundësinë e përfshirjes së një eksperti të jashtëm në përbërje të saj, por kjo nuk është e detyrueshme dhe aktualisht njësia nuk ka një të tillë. Kjo njësi gëzon pavarësi në veprimtarinë e saj dhe ka qasje të plotë në të dhënat institucionale. Ajo zhvillon punën e saj në bashkëpunim me njësitë bazë, duke organizuar dhe ndjekur proceset që lidhen me kontrollin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Evidenca: <i>Rregullore e njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FSHS;</i> <i>Të dhëna për anëtarët e NJBSC;</i> <i>Statuti i Universitetit të Tiranës, Kreu X, neni 139;</i> <i>Rregullore e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë;</i> <i>Përshkrimi i veprimtarisë së Njësisë së Sigurimit të Cilësisë;</i> <i>Paketa e Instrumentave të Cilësisë.</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Institucioni ka miratuar Paketën e Sigurimit të Cilësisë, përfshirë instrumentet përkatëse, të aprovuar nga Senati i UT më 23.12.2020. Fakulteti i Shkencave Sociale përdor mekanizma të vazhdueshëm vlerësimi si takime, sondazhe dhe pyetësorë anonimë për studentët, për të monitoruar cilësinë e mësimdhënies dhe zhvillimin e programeve të studimit. Vlerësimi i stafit akademik përfshin performancën mësimore, kërkimin shkencor dhe kontributin institucional, ndërsa përgjegjësit e departamenteve plotësojnë formularë përkatës në fund të vitit akademik. Gjithashtu analizohet edhe angazhimi administrativ i stafit. Të gjitha të dhënat përmbledhen në raporte vjetore, ku evidentohen problematikat dhe propozohen masa për përmirësim të cilësisë. Evidenca: <i>1.11. Manuali i Cilësisë;</i> <i>Paketa e instrumenteve të sigurimit të cilësisë.</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor	Universiteti i Tiranës, përmes Komisionit të Përhershëm për

tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Sigurimin e Standardeve të Cilësisë dhe Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në fakultete, zhvillon dhe zbaton politikat e vlerësimit të cilësisë, në përputhje me Rregulloren dhe Manualin e Cilësisë, si dhe aktet përkatëse në nivel fakulteti. Këto dokumente përcaktojnë procedurat dhe afatet për monitorimin e cilësisë së programeve të studimit. Politikat e vlerësimit zbatohen në nivel institucional, duke u koordinuar me aktorët e brendshëm dhe duke përdorur tregues matës për të monitoruar performancën e programeve. Fakulteti mbledh dhe analizon të dhëna nga instrumentet e cilësisë (si pyetësorët), të cilat përfshihen në vlerësimet e brendshme dhe pasqyrohen në raportet periodike të Njesisë së Sigurimit të Cilësisë. Rezultatet e vlerësimit publikohen në raportin vjetor, duke siguruar transparencë dhe përmirësim të vazhdueshëm. Evidenca: <i>Raport periodik i NJSBC;</i> <i>Paketa e instrumentave të cilësisë;</i> <i>Rregullorja për sigurimin e cilësisë;</i> <i>1.11. Manuali i cilësisë.</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni e përmbush këtë standard plotësisht pasi vlerësohet se ka plotësuar kriteret 1-4, duke themeluar NJSBC-në, duke rregulluar përbërjen e saj, duke përfshirë edhe ekspertë të jashtëm, duke pasqyruar në mënyrë periodike vlerësimin akademik dhe shkencor të stafit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi VI.3 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të	Bazuar dhe në RVB, departamenti është përfshirë në vlerësimin e programit të studimit. Vlerësimit bëhet në formë të dokumentuar në çdo mbledhje, që shqyrton mbarëvajtjen e procesit mësimor. Në përfundim të vitit akademik, i gjithë stafi mbledhet dhe diskuton mbi veprimtarinë e departamentit, duke kontribuar edhe në përgatitjen e raportit vjetor.




programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Ndërsa NJSBC ka zhvilluar dhe implementuar mekanizma dhe instrumenta për monitorimin e zhvillimit të programit të ciklit të dytë (MSc në "Filozofi Sociale"), duke vlerësuar përmbajtjen e lëndëve, elementët praktikë, profesionale dhe ndërdisiplinorë, që përfshin ky program. Pyetësorët, si mekanizma rutinë dhe efektive, analizohen dhe përfshihen në raportet periodike të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila mbështetet në standardet dhe udhëzimet për sigurimin e cilësisë në hapësirën evropiane të Arsimit të Lartë. Pas përfundimit të procedurave të rishikimit dhe përmirësimit të programit, konkluzionet e vlerësimeve iu dërgohen autoriteteve vendimmarrëse, si përgjegjësit e departamentit dhe dekanit, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Të gjitha rezultatet bëhen pjesë e analizave vjetore të njesisë bazë dhe të njesisë kryesore. Evidenca: <i>1.14. Paketa e instrumentave të Cilësisë;</i> <i>Strategjia e zhvillimit të Departamentit të Filozofisë;</i> <i>Analizë vjetore e punës së Departamentit të Filozofisë 2023-2024;</i> <i>Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale.</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Raportet e vlerësimit të NJSBC-së përfshijnë rezultatet, arritjet, identifikimin e mangësive dhe masat, që duhet të ndërmerren për përmirësimin e rezultateve. Bazuar dhe në RVB, këto të dhëna përdoren nga raporti i vlerësimit të brendshëm të Departamentit dhe Fakultetit. Raporti vjetor i Departamentit përmban të dhëna për realizimin e qëllimeve dhe arritjet e programeve të studimit, projektet, kërkimin shkencor të lektorëve dhe studentëve, të dhëna nga programet e studimit, rregulloret, ngarkesën e punës, vlerësimet, përfaqësimin studentor në këshilla dhe të dhëna specifike për arritjet e studentëve dhe të të diplomuarve. Evidenca: <i>Analizë vjetore e punës së Departamentit të Filozofisë 2020-2021;</i> <i>Strategjia e zhvillimit të FSHS 2018-2023;</i> <i>Strategjia e zhvillimit të programit të studimit MSc në "Filozofi Sociale".</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e	Institucioni në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës,

cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve, apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale, apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale, apo kombëtare, si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. Gjithashtu, është miratuar formulari i vlerësimit të vazhdueshëm, i cili përfshin elementë si, silabusi, metodat e mësimdhënies, vlerësim të detyrave dhe projekteve, etj. Evidenca: <i>Raport periodik i NJSBC;</i> <i>Paketa e instrumenteve të sigurimit të cilësisë;</i> <i>Rregullore për sigurimin e cilësisë në FSHS;</i> <i>Manuali i cilësisë.</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.	Institucioni përdor gjithashtu metoda të tërthorta për vlerësimin e programit të studimit, ku përfshihen: Anketa e vlerësimit të pedagogut dhe lëndës, që përmban aspekte si përmbajtja e lëndës, mësimdhënia dhe të nxënit, mënyra e vlerësimit, njohja me silabusin, etj. Rezultatet e këtyre vlerësimeve shërbejnë për progresin dhe rritjen e cilësisë së programit të studimit. Ato përfshijnë veprimet për ndreqjen e mangësive dhe rritjen e mëtejshme të cilësisë në procesin mësimor dhe akademik, të cilat janë të përfshira edhe në analizën vjetore të departamentit. NJSBC ka realizuar diskutime të vazhdueshme për sigurimin e cilësisë, duke zbatuar planin strategjik për përmirësimin e cilësisë në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe zhvillimin e programeve të studimit. Metodatat e vlerësimit përfshijnë sondazhe nga studentët dhe vlerësime për mësimdhënien, që mbulojnë aspekte si përmbajtja e lëndës, metodologjia, organizimi i mësimin, dhe lidhja teorike dhe praktike. Po ashtu, përdoren intervista dhe pyetësorë për të mbledhur mendime dhe sugjerime nga studentët për përmirësimin e procesit. Evidenca: <i>1.14.Paketa e instrumenteve të cilësisë.</i>
Konkluzione	Standardi përmbushet, pasi plotësohen kriteret e përcaktuara. Rezulton se institucioni nëpërmjet departamentit është përfshirë

	në vlerësimin e programit të studimit. Vlerësimi bëhet në formë të dokumentuar në çdo mbledhje, që shqyrton mbarëvajtjen e procesit mësimor. Institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta vlerësimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Bazuar në RVB institucioni ka garantuar përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në strukturat përgjegjëse për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Shkencave Sociale, si institucione akademike, synojnë rritjen e vazhdueshme të standardeve brenda hapësirës evropiane të Arsimit të Lartë. Pjesë e këtij angazhimi janë grupet e punës për sigurimin e brendshëm të cilësisë, si dhe angazhimi në proceset periodike të vlerësimit të jashtëm. Gjithashtu, institucionet ofrojnë mbështetje dhe bashkëpunim në nivel institucional për sigurimin e cilësisë, duke përfshirë sondazhin kombëtar të studentëve, si mjet vlerësimi për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Evidenca: <i>Statuti i Universitetit të Tiranës;</i> <i>Manuali i Cilësisë;</i> <i>Manuali i Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik të UT-së;</i> <i>Rregullore e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FSHS.</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të	NJSBC funksionon sipas rregullores së saj dhe ka të qarta detyrat dhe përgjegjësitë për individët, studentët dhe palët e tjera, si dhe vepron në mënyrë autonome, duke ushtruar detyrat e saj me përgjegjësi. Ajo kryen gjithashtu vlerësime të vazhdueshme të programeve të studimit për të siguruar përputhshmërinë me standardet dhe

cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	koherencën e tyre. Detyrat dhe përgjegjësitë e këtij komisioni, si për stafin ashtu edhe për studentët dhe palët e interesuara, janë të përcaktuara qartë në Statutin e UT. Gjithashtu, institucionet përcaktojnë role të qarta për njësitë e sigurimit të cilësisë në nivel fakulteti, sipas rregullores përkatëse. Evidenca: <i>Statuti i Universitetit të Tiranës, kreu X;</i> <i>Rregullore e njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FSHS.</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Vendimi për krijimin e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FSHS është në funksion të monitorimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë akademike. Për vlerësimin e programit të studimit MSc në "Filozofi Sociale" vepron gjithashtu një grup pune i posaçëm për vlerësimin e brendshëm të këtij programi. Ky grup propozohet nga njësia përgjegjëse për programin dhe miratohet nga Dekani, në përputhje me procedurat përkatëse. Evidenca: <i>Vendim për ngritjen e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;</i> <i>Propozimi i njësisë bazë për grupin e vlerësimit të brendshëm;</i> <i>Vendimi për ngritjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm nga Dekani.</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Përfshirja e aktorëve të brendshëm bëhet gjithmonë duke respektuar integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie. Senati akademik ka për detyrë të garantojë respektimin e integritetit të të gjithë aktorëve të përfshirë në vlerësimin e cilësisë dhe të evitojë çdo lloj pabarazie apo diskriminimi ndaj të gjithë studentëve apo stafit akademik. Aktivizimi i personelit dhe studentëve respekton integritetin. Proceset ciklike të vlerësimit respektojnë integritetin akademik dhe shmangin çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Evidenca: <i>Manuali i Cilësisë;</i> <i>Rregullorja e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FSHS.</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e	Institucioni organizon takime të vazhdueshme me profesionistë të

proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	fushave të programeve, që ofron të cilët krahas ekspertizës informojnë edhe me dinamikat e tregut të punës me qëllim përcjelljen e tyre për ndryshime në programin përkatës. Gjithashtu, bashkëpunimet me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, apo me ekspertë të organizmave shtetërorë dhe joqeveritarë, ndihmojnë në shkëmbimin e përvojave dhe avancimin e cilësisë akademike.			
Konkluzione	Evidenca: <i>Tabela përmbledhëse për Marrëveshjet e Bashkëpunimit; Raport periodik mbi përfitimet nga marrëveshjet në funksion të programit.</i>			
	<i>Institucioni ka garantuar përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në departament për sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Në përbërje të NJSBC-së, ka përfaqësues të studentëve dhe gjithashtu vërehet prania e ekspertit të jashtëm.</i>			
	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Shkalla e përmbushjes së standardit				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politikat dhe strategjia për sistemin e sigurimit të cilësisë në programet e studimit janë të përfshira në Statutin e Universitetit të Tiranës, i cili mund të aksesohen në faqen e tij zyrtare. Po ashtu, Strategjia e Zhvillimit të Universitetit përmend gjithashtu veprimet dhe politikat lidhur me cilësinë, dhe ky dokument është i hapur dhe transparent për të gjithë interesuarit përmes faqes zyrtare: https://unitir.edu.al/strategjia-e-zhvillimit-te-universitetit-te-tiranes/. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucional publikon raportet e vlerësimit të brendshëm në formë të shtypur, të cilat janë të disponueshme për studentët dhe pedagogët. Evidenca: <i>Raport periodik i NJSBC (ose raport vjetor i NJSBC); https://unitir.edu.al/statuti-ut-es/</i>

	https://unitir.edu.al/strategjia-e-zhvillimit-te-universitetit-te-tiranes-/
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Rezultatet vijnë nga analiza e departamentit, fakultetit dhe pyetësorëve të anketimeve të realizuara nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë me studentët. Vlerësimet zhvillohen në kushte anonimatit dhe u prezantohen studentëve në mbledhje të hapura dhe takime me grupe studentësh. Evidenca: <i>Rregullore e Universitetit të Tiranës për "Mbrotjtjen, Përpunimin, ruajtjen dhe sigurimin e të dhënave personale në Universitetin e Tiranës";</i> <i>Analizë vjetore e punës së Departamentit të Filozofisë;</i> <i>Raport vjetor i sigurimit të cilësisë bazuar në pyetësorët e studentëve;</i> <i>Raport vjetor i NJSBC.</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Të gjitha vlerësimet periodike shoqërohen me plan masash, ku u referohen pikave të forta të programit dhe të Departamentit. Ato përmbajnë sugjerime për aspekte, që Departamenti mund të përmirësojë. Në kuadër të funksionimit të njësisë bazë, rezultatet e vlerësimeve shoqërohen me një plan veprimi, që hartohet në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Vlerësimi vjetor i punës së Departamentit dhe Fakultetit, përveçse analizon arritjen e objektivave dhe zhvillimin e programeve të studimit, përfshin edhe propozime për përmirësim, objektiva të rinj dhe masa konkrete për të adresuar çështjet e konstatuara. Po ashtu, raportet e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përmbajnë rekomandime, që i paraqiten dekanatit, në mënyrë që të ndërmerren hapa të qarta dhe të planifikuara për përmirësimin e situatës. Evidenca: <i>Analizë vjetore e punës së Departamentit të Filozofisë;</i> <i>Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale;</i> <i>Raport vjetor i NJSBC.</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e	Siç rezultoi nga analiza e GJVJ-së, raportimet e NJSBC-së përdoren në mënyrë efikase nga institucioni, duke i shpërndarë çështjet dhe ndjekur ato që kanë nevojë për përmirësim të

veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	vazhdueshëm. Fokusi kryesor është monitorimi i procesit mësimor, cilësia e programit të studimit, programi i praktikës dhe ndryshimi në jetën akademike të aktiviteteve jashtëkurrikulare. Evidenca: Strategjia e Zhvillimit të FSHS; Strategjia e zhvillimit të Departamentit të Filozofise; Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Departamenti i Filozofisë, në kuadër të Fakultetit të Shkencave Sociale, zhvillon në mënyrë të rregullt takime mes studentëve dhe stafit akademik, me synimin për të krijuar një hapësirë dialogu të hapur. Gjatë këtyre takimeve, studentët inkurajohen të ndajnë mendimet, sugjerimet dhe vërejtjet e tyre lidhur me procesin mësimor, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit. Evidenca: 2.16. Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale 2021-2022, 2022-2023.			
Konkluzione	<i>Veprimtaria e NJSBC-së është transparente dhe mund të aksesohet publikisht në faqen e dedikuar të saj ku ndodhen të gjitha raportimet e saj. Institucioni organizon në mënyrë periodike takime informuese me stafin dhe studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Filozofi Sociale” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Kurrikula e programit reflekton përmirësime të vazhdueshme në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke mundësuar integrimin në procesin e ndërkombëtarizimit përmes partneriteteve me institucione dhe organizata jashtë vendit.
2. Aksesit i gjerë në literaturë akademike, si në format fizik ashtu edhe elektronik, ka ndikuar pozitivisht në cilësinë kërkimore dhe akademike të studentëve dhe stafit.
3. Programi, me natyrë ndërdisiplinore dhe fokus në filozofinë sociale, ka krijuar partneritete të qëndrueshme me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe brenda vetë Universitetit të Tiranës.
4. Mbështetje për studentët: Stafi akademik dhe administrativ ofron mbështetje të plotë për studentët, duke i orientuar jo vetëm në mësim, por edhe në karrierë dhe tregun e punës.
5. Kualifikimi i stafit: Institucioni ka prioritet rekrutimin e stafit të kualifikuar dhe rikualifikimin e vazhdueshëm, me pedagogë që kanë përfunduar studimet doktorale dhe fituar tituj akademikë.
6. Mobilitet dhe ndërkombëtarizim: Mobiliteti i stafit kontribuon në lidhjet me rrjetet akademike ndërkombëtare dhe zhvillimin e programit.
7. Sigurimi i cilësisë: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë siguron monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe arritjen e objektivave të programit.
8. Marketingu dhe regjistrimet: Mungesa e regjistrimeve të reja tregon nevojën për përmirësimin e marketingut dhe marrëdhënieve publike.
9. Profili i studentëve: Programi ka një përbërje të larmishme studentore, duke integruar studentë nga disiplina të ndryshme dhe profesionistë të fushave të ndryshme.
10. Punësimi i studentëve: Studentët kanë arritur sukses në tregun e punës dhe në karrierë, duke pasur një qasje të ngjashme me standardet ndërkombëtare.

Pika të dobta:

1. Numri i ulët i mobiliteteve.
2. Lidhje jo e konsoliduar e emërimit të njësive kryesore (filozofia si humanitet) me njësine bazë (shkencat sociale).
3. Promovimi i pamjaftueshëm i programit për publikun e interesuar, në kontekstin e dinamikave të zhvillimeve kombëtare dhe ndërkombëtare e të problematikave sociale, që lindin e që lidhen me mjedise të ndryshme të shoqërisë, ku lind nevoja e ekspertizës edhe të diplomuarit e këtij lloji masteri.
4. Numri i studentëve: Varion nga 10-20 studentë në vit për programin e ciklit të dytë, ndikuar nga faktorët demografikë dhe socialë, sidomos pas pandemisë.

5. Ekspertiza: Përdorimi i pedagogëve të jashtëm për të përmirësuar cilësinë dhe ekspertizën vendase.
6. Mobiliteti ndërkombëtar: Numri i kufizuar i mobiliteteve të studentëve dhe pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare mbetet një sfidë, por është duke u trajtuar me përparësi.
7. Vlerësimi: Ky program ka vlerë të rëndësishme për nivelin e dytë të studimeve në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe më gjerë.

Rekomandime

1. Stafi të ketë një mbështetje më të madhe financiare nga ana e institucionit.
2. Institucioni, përmes mekanizmave të vlerësimit dhe analizimit të rezultateve, të inkurajojë përhapjen e praktikave më të mira dhe të mbështesë personelin akademik në përpjekjet e tij për përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor.
3. Të punohet më tej për mundësitë e zgjerimit të hapësirave për praktikën mësimore e aksesin në tregun e punës, meqë është edhe një program i veçantë me karakter social.
4. Të punohet më tej me përkthimet e zgjerimin e literaturës me botime përkatëse në gjuhën shqipe; veçanërisht në fusha të reja, si ato të Bioetikës.
5. CV-të të jenë sipas formatit Europass të standardeve ndërkombëtare, duke unifikuar dhe formatin e të gjitha CV të stafit akademik.
6. Njësia të jetë më korrekte me dokumentacionin ilustrues dhe saktësinë e tij.
7. Rekomandohen studime periodike dhe takime me studentët dhe palët e interesuara, me qëllim përmirësimet kurrikulare dhe forcimin e bashkëpunimit me institucionet partnere.

Conclusions of the Evaluation of the Second Cycle Study Program “Master of Science in Social Philosophy” offered by the Higher Education Institution “University of Tirana”

Strengths and Affirmations:

1. The program’s curriculum reflects continuous improvements in line with current legislation, enabling integration into the internationalization process through partnerships with institutions and organizations abroad.
2. Broad access to academic literature, in both physical and electronic formats, has positively influenced the research and academic quality of students and staff.
3. The program, with its interdisciplinary nature and focus on social philosophy, has established sustainable partnerships with national and international institutions, as well as within the University of Tirana itself.

4. Student support: The academic and administrative staff provide comprehensive support to students, guiding them not only in learning but also in career development and the labor market.
5. Staff qualification: The institution prioritizes the recruitment of qualified staff and continuous requalification, with lecturers holding doctoral degrees and academic titles.
6. Mobility and internationalization: Staff mobility contributes to connections with international academic networks and the development of the program.
7. Quality assurance: The Internal Quality Assurance Unit ensures continuous monitoring of quality and the achievement of program objectives.
8. Marketing and enrollment: The lack of new enrollments indicates the need for improved marketing and public relations.
9. Student profile: The program has a diverse student composition, integrating students from various disciplines and professionals from different fields.
10. Student employment: Students have achieved success in the labor market and in their careers, aligning with international standards.

Weaknesses:

1. Low number of mobilities.
2. The connection between the name of the main unit (philosophy as a humanity) and the base unit (social sciences) is not well consolidated.
3. Insufficient promotion of the program to the interested public, in the context of national and international developments and social issues, which arise and are linked to various societal environments, where the expertise of graduates from this type of master's program is needed.
4. Number of students: Ranges from 10–20 students per year for the second-cycle program, influenced by demographic and social factors, especially after the pandemic.
5. Expertise: Use of external lecturers to enhance quality and local expertise.
6. International mobility: The limited number of student mobilities and participation in international projects remains a challenge, though it is being prioritized.
7. Evaluation: This program holds significant value for the second level of studies at the Faculty of Social Sciences and beyond.

Recommendations:

1. Staff should receive greater financial support from the institution.
2. The institution, through evaluation and result-analysis mechanisms, should encourage the dissemination of best practices and support academic staff in their efforts to continuously improve the teaching process.
3. Further work is needed to expand opportunities for teaching practice and access to the labor market, as it is a special program with a social character.
4. Further work is needed on translations and the expansion of literature with relevant publications in the Albanian language; especially in new fields such as Bioethics.
5. CVs should follow the Europass format in line with international standards, unifying the format of all academic staff CVs.
6. The unit should be more accurate with illustrative documentation and its correctness.
7. Periodic studies and meetings with students and stakeholders are recommended, in order to improve the curriculum and strengthen cooperation with partner institutions.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X